

# Rrugat Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (45). JANAR 2010. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

**AURORA GROUP**

PROJEKTIM - ZBATIM

*koja kalon, cilësia mbetet*

Autostrada Tirane - Durres, Km.9

Tel: +355 48 30 2046

Tel: +355 48 30 2040

www.auroragroup.com.al

e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

## PROFIL

### Profesor me vepra, jo veç me tituj...

Nga: **SHAQIR SKARRA** - FAQE 13

## VESHTRIME

### Dibra, djepi i diturisë

Nga: **ARBANA QORMEMETI** - FAQE 9

## LETËRSI

### Spiralja e hijshme e ngjitjes

Nga: **VIRION GRAÇI** - FAQE 12

## TREGIM

### Mjeku i pagabueshëm

Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 14

## SHENIM

### Skavica

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Ndoshta nuk do të merrej njeri këto ditë të ftohta dimri me një projekt që ka nisur qysh para viteve nëntëdhjetë nga qeveria shqiptare. U desh të përmytej Shkodra e Lezha e ja tani përsëri na del në skenë Skavica, një hidrocentral ky që po të ndërtohet siç thonë nuk mund të ndodhin këto përmytje në Shkodër. Nuk ka asnjë të keqe këtu, fundja fjala e specialistit nuk është fjalë dosido. I pari foli Komisari i Italisë për Digat, Roberto Guercio, i dërguar në Shqipëri pas situatës kritike të krijuar nga përmytjet që ndodhën ditët e fundit. Duke folur në një emision televiziv lidhur me sigurinë që paraqet zinxhiri i ujë mbledhësve mbi lumin Drin, Roberto deklaroi se një ndihmë shumë të madhe për të shmangur situata emergjente do të kishte qenë ndërtimi në kohë i hidrocentralit të Skavicës, që është edhe HEC-i i parë mbi Drin sipas projektuesve shqiptarë të Kaskadës. "Natyrisht që do të kishte qenë një mjet i mirë për të shmangur katastrofa përmytjesh", -tha ai. Në fakt projekti i Skavicës ka qenë i gatshëm prej vitesh në dispozicion të qeverisë shqiptare, madje prej disa vjetësh u caktua edhe konsorciumi Italian, që do të ndërtonte atë me koncesion, me financime që kalonin të 600 milion eurot. Qeveria Berisha vendosi të ndryshojë skemën e HEC-it pas së cilës ajo shpalli sërish tenderin ndërkom-bëtar. Ky tender u zhvillua në dhjetor të vitit të kaluar, por këtë herë asnjë subjekt, as i huaj dhe as vendas nuk paraqiti interes duke bërë kështu të dështojë tenderi. E kjo edhe pritej në një kohë kur kriza globale i ka bërë Bankat dhe kompanitë e mëdha financuese tepër të kujdesshme në drejtim të kredive të mëdha, aq më tepër në vende si Shqipëria. Fill pas Komisarit Italian folën dhe specialistët shqiptarë.

(Vijon në faqen 2)

## Skavica, a i bën dëm Dibrës?

**FTESË PËR DEBAT:** Ku janë dibranët, ku janë intelektualët, ekologët, historianët, arkeologët e ndershëm shqiptarë? A ka alternativë tjetër përveç alternativës së mbytjes së Dibrës?


Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Përmytja e fushës së Shkodrës, në ato përmasa tashmë të deklaruara (11.400 hektarë dhe 2649 shtëpi) përbën katastrofën më të madhe ujore të njohur në Shqipëri, katastrofë mbi shtëpitë dhe pasuritë e ngritura me gjakun dhe djersën e njerëzve në emigrim apo jo, mbi tokën dhe prodhimet e saj, mbi blegtorinë dhe bazën e saj ushqimore (të thatë, të koncentruar e të njomë), mbi gjallesa në shërbim të njeriut (pula, dele, qengja, lopë...) etj.

Katastrofa e Shkodrës mund të themi me plot gojën se erdhi "nga Zoti" dhe "nga Robi", katastrofë e lidhur me reshjet mbi pellgun ujëmbledhës që nga Struga, Rrafshi i Dukagjinit e deri nga Alpet e Veriut, por edhe nga mosmenaxhimi i situatës në ujëmbledhësit e mëdhenj në Fierzë, Koman e Vaun e Dejës duke shtuar këtu edhe gjendjen e patolerueshme të kanaleve kullues, digave, hidrovoreve, lumit të Bunës etj.

Përmytja e Shkodrës është tashmë një realitet sa i dhimbshëm po aq edhe tregues se në këtë zonë (ashu si edhe në zona të tjera të Shqipërisë) prej njëzet vjetësh ka munguar shteti. Kur them "ka munguar shteti" nuk kam parasysh vetëm Berishën e Parë dhe Meksin që ka dominuar vitet 1991-1997 (kur "kuota zero" në pritje të "çekut të bardhë" ishte fjalë e ditës) por edhe vitet 1997-2005 me serinë e kryeministrave socialistë: Nano, Majko, Meta e prapë Nano.

(Lexoni në faqe 2-3)



## Qyteti i Peshkopisë nga lashtësia në ditët tona

Nga: **MOISI MURRA**

Qyteti i Peshkopisë gjendet në koordinatat gjeografike: gjatësi lindore 20°25'25" dhe gjatësi veriore 41°40'56". Ngrihet në një terren malor të gjelbëruar të Shqipërisë verilindore, në lartësinë mbi detare 656m. Kur në Evropën Qendrore ora

është 12, 00, ora lokale në Peshkopi shënon 12.00 21' 43". Rajoni i Dibrës është i banuar që në mijëvjeçarin e VI p.e.s. Në antikitet treva e sotme e Dibrës njihet me emrin **Penestiana Terra** (Toka e Penesteve).

(LEXONI NE FAQE 8)

## OPINION

### Kambanat bien për reflektim

Nga: **XHEMAL MATO HAKI KOLA**

FAQE 4

## INTERVISTË

### Paçuku: Investimet nga diaspora, rast që nuk duhet humbur

Nga: **BEQIR SINA**

FAQE 6

## HISTORI

### "Nuk duen "babë", nuk duen dovet, ato duen shtëpinë e vet"

Nga: **ZABIT QAMIL LLESHI**

FAQE 11

## AKTUALITET

### Do të hiqen emërtimet serbosllave

FAQE 5

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.


Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Bujar Plloshitani, Mahmud Hysa, Rexhep Ndreu, Xhelal Roçi, Abdurahim Ashiku, Beqir Sina, Fatmir Minguli, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, Dukagjin Hata, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër. Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më datë 20 të muajit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:  
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:  
Musa Riçku  
Shaqir Skarra  
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:  
Abdurahim ASHIKU  
Xhafer MARTINI  
Veseli HOXHA  
Xhemal MATO  
Haki KOLA  
Moisi MURRA  
Arbana QORMEMETI  
Zabit QAMIL LLESHI  
Virion GRAÇI  
Beqir SINA  
Islam ÇENGA  
Shpëtim CAMI  
etj.

Adresa e gazetës:  
Rr. "Zenel Baboçi",  
Pall. "Ferar", Tiranë  
Tel. +355 4 22 33 283  
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë



SHENIM

## Skavica

(Vijon nga faqja 1)

Luigj Pjetri, një ndër specialistët e hidrocentraleve tha: "Skavica do shmang përmbytjet në fushën e Shkodrës. Qysh kur ka nisur projekti i Kaskadës së Drinit janë përfshirë në të të ndërtoheshin 5 hidrocentrale. Tre janë ndërtuar, kështu që mbeten edhe dy për t'u ndërtuar që janë Skavica dhe Bushati. Në fakt projekti i Skavicës i projektuar herët e kanë kaluar shumë vite deri atëherë, ai ende nuk u ndërtua. Fundja edhe ndërtimi i Kaskadës duhej të fillonte nga fillimi, d.m.th nga Skavica por ja që kështu nuk u nis. Lind me të drejtë pyetja; Pse? Po të ndërtohet Skavica do të përmbytet Dibra, e gjithë ajo luginë e bukur e mjaft pjellore e Drinit të Zi. Do të zhduket një histori kombëtare që me të drejtë nuk mburret vetëm Dibra por e gjithë Shqipëria. Ajo luginë e mbushur me bëma historike të një kombi ndër vite do të zhduket në një kohë të shkurtër e do të kthehet në një liqen gjigand. A thua vetem Skavica e shpëton Shkodrën nga përblytjet? Sot në Ministrinë e Energjitikës dhe Ekonomisë, sipas një burimi të sigurtë, janë mbi 400 kërkesa për të ndërtuar hidrocentrale të vegjël. Një hidrocentral i tillë përafërsisht prodhon mbi 1000 kw energji elektrike. Atëherë me të drejtë shtrohet pyetja: Pse rëndet pas këtyre digave të mëdha që krijojnë shpërngulje masive të popullsisë kur kemi mundësi të ndërtojmë hidrocentrale të vegjël me pak shpenzime e me shumë leverdi për të siguruar energji, lere pastaj tecet që po ndërtohen e do të ndërtohen në të ardhmen. Vetëm mbi Setë në Arras një firmë italiane ka ngritur tashmë një hidrocentral të vogël ku janë montuar edhe makineritë. Të vogël i thonë por ka një kapacitet mbi 4000 kw. Po sa kemi të tillë në Dibër si Selishtë, Lurë, Kala të Dodës etj? Skavica po të ndërtohej sipas projektit norvegjez, me prita të vogla mbi dhjetë metra që nga ura e Topojanit e deri në ngushticën e Skavicës do të prodhohet energji dhe do të shpëtonim nga përmbytja një zonë të tërë siç është Dibra. Për të shpëtuat Dibrën nga ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës u ngrit dhe një shoqatë me emrin "Brigjet e Drinit të Zi" të cilët kanë bërë edhe takime në Ministrinë e Energjitikës. Janë shkruar mjaft shkrime në organe të ndryshme të shtypit ku kanë hedhur mendime njerëz të ndryshëm se a duhet në fakt të ndërtohet Skavica apo jo. E nde specialistët e digave të mëdha nuk e kanë dhënë mendimin e tyre për Skavicën. Mjaft firma janë afruar për këtë projekt të madh energjetik. Ende qeveria ka heshtur, nuk është ulur as në zonat që përmbyten nga ky projekt sikur u shprehën atë ditë në takim me shoqatën. Sot kur ndodhi kjo përmbytje filluan disa si nën zë të flasin se është pikërisht Skavica ai që shpëton nesër Shkodrën nga përmbytja. Po Dibrën kush e shpëton? Vërtet kush po e kërkon të përmbytet Dibra? A ia vlen të krijohet një dëm kaq i madh për të ndërtuar një hidrocentral si Skavica. Sa pronarë do të dëmshpërblehen? Sa familje do të shpërngulen? A është bërë një studim i tillë për dëmet që mund të shkaktojë Skavica apo o burra kemi një projekt dhe hajde ta bëjmë. Ne jemi shquar për ndërtime digash të mëdha sa dhe vende si Kanadaja na kanë zili, ne jemi shquar për sigurimin e energjisë elektrike nga burime hidrike por nuk jemi marrë me studime të tjera se si mund të prodhojmë energji pa dëmtuar, tokë, shtëpi e prona të tjera. Jo për këto tek ne askush nuk mendon. Ne kemi shprehur gadishmëri edhe për energji bërthamore e ku vetë Italia fqinje na mbështeti në këtë projekt. Megjithatë problemet nuk janë kaq të thjeshta sa duken në projekt. Skavica është një projekt ndoshta madhor për kombin por shkatërrimtar për Dibrën. Për këtë Dibra dhe dibranët e kanë dhënë fjalën e tyre. Kur kemi mundësi të tjera për të prodhuar dhe siguruar energji elektrike nuk ka pse të ndërtohet Skavica. Sa kohë mund tju duhej italianëve për të vendosur për një projekt të tillë? Ndoshta vite të tëra. Atëherë pse ne duhet të vendosim kaq shpejt. Besoi nuk është as koha, as momenti për projektin e Skavicës. Nuk duhet përdorur ky projekt si gogoli për të trembur atë popullsi të pafajshme të cilët janë në vendin e tyre e kanë frikë të investojnë akoma. Skavica fle çdo mbrëmje në vatrat e dibranëve. Deri kur gogoli Skavica do të endet lirshëm luginës së Drinit të Zi?

Sh. Skarra

Nga: ABDURAHIM ASHIKU

Përmbytja e fushës së Shkodrës, në ato përmasa tashmë të deklaruara (11.400 hektarë dhe 2649 shtëpi) përbën katastrofën më të madhe ujore të njohur në Shqipëri, katastrofë mbi shtëpitë dhe pasuritë e ngritura me gjakun dhe djersën e njerëzve në emigrim apo jo, mbi tokën dhe prodhimet e saj, mbi blegtorinë dhe bazën e saj ushqimore (të thatë, të koncentruar e të njomë), mbi gjallesa në shërbim të njeriut (pula, dele, qengja, lopë...) etj.

Katastrofa e Shkodrës mund të themi me plot gojë se erdhi "nga Zoti" dhe "nga Robi", katastrofë e lidhur me reshjet mbi pellgun ujëmbledhës që nga Struga, Rrafshi i Dukagjinit e deri nga Alpet e Veriut, por edhe nga mosmenaxhimi i situatës në ujëmbledhësit e mëdhenj në Fierzë, Koman e Vaun e Dejës duke shtuar këtu edhe gjendjen e patoluerueshme të kanaleve kullues, digave, hidrovoreve, lumit të Bunës etj.

Përmbytja e Shkodrës është tashmë një realitet sa i dhimbshëm po aq edhe tregues se në këtë zonë (ashtu si edhe në zona të tjera të Shqipërisë) prej njëzet vjetësh ka munguar shteti. Kur them "ka munguar shteti" nuk kam parasysh vetëm Berishën e Parë dhe Maksin që ka dominuar vitet 1991-1997 (kur "kuota zero" në pritje të "çekut të bardhë" ishte fjalë e ditës) por edhe vitet 1997-2005 me serinë e kryeministrave socialistë: Nano, Majko, Meta e prapë Nano. Kam parasysh edhe Berishën e Dytë nga citi 2005 e deri sot, përfshirë këtu edhe krahët e "dy krahëve", serinë homologe të ministrave të energjetikës, bujqësisë, transportit, ekonomisë, financave etj.

Një analizë me letrat e hapura "Çfarë bënë të tjerët (para vitit 1990) dhe çfarë nuk bënë ne (më troç: çfarë shkatërruam dhe vodhëm ne) në vitet 1990-2010 vite të politikës "të djathhtë" e të "majtë" shqiptare, një vetëoperacion është i domosdoshëm në qoftë se nuk duam të përballemi nesër me ndodhi të tilla. Të presësh lëmshë nga natyra, të shtrish duart duke iu lutur asaj, pa punuar që t'ia rrëmbesh vlerat, nuk është gjë tjetër veçse një theqafje.

Nuk kam ndërmend të bëj as prokurorin dhe as avokatin e Përmbytjes së Shkodrës, togjalësh shumë i lakuar këto ditë. Këtë le ta bëjë politika dhe shogëria shqiptare në një gjyq jo vetëm për të treguar me gisht fajtorët por edhe në një paralajmërim për të ardhmen.

Fjalën e kam se po ndodh që "Përmbytja e Shkodrës" po çon verbërisht në "Mbytjen e Dibrës".

"Përmbytja" dhe "Mbytja" ndryshojnë gramatikisht vetëm nga parashtesa e së parës "për-mbytja".

Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (të cilin e mbaj me vete në emigracion) fjalët "përmbyt", "përmbytem", "përmbytje" zbërthehen si: "E mbyt me ujë të shumtë", "Drini përmbyt fshatra të tëra", "I mbuluar nga ujërat e tepërta të shirave apo të lumenjve a përrrenjve", "Fushë e përmbytur" etj.

Fjalët "mbyt", "mbytem", "mbytje" në të gjitha rastet e treguara (përveç atyre figurative) ka kuptimin vrasës, vdekës: "e bëj të vdesë", "e vras duke e goditur", "nuk e lë të marrë frymë", "shtyp me dhunë", "që është fundosur në ujë", "anija e mbytur"...

"Përmbytja e Shkodrës" dhe "Mbytja e Dibrës" janë në segmentin e dy të kundërtave që i ikin njëra tjetrës. E para ka shansin e jetës, shansin që "Drini" pasi "përmbyt

**XHEMAL MATO:  
Intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt. Gjithashtu me ligj ata kanë të drejtë ta anulojnë. Kjo është rruga ligjore!**

fshatra të tëra" kthehet në shtratin e vet me paralajmërimin e natyrës memecë se do të vijë përsëri. E dyta, "Mbytja e Dibrës", nuk e ka këtë shans. E humb përgjithmonë ashtu siç e humbën fshatrat që mbyti liqeni artificial i Ulzës, i Fierzës, Banjës etj. Kukësi tashmë është i mbytur ashtu siç janë mbytur fshatrat e tjerë. Ulza është e mbytur dhe ndonjë gjurmë e shtëpive apo pemëve të fshatrave nën ujë mund të shihet vetëm në thatësitë ekstreme. Darëzeza në liqenin e Banjës "jeton" vetëm në shtëpitë e ndërtuara midis pishave vetëm disa dhjetëra metra larg bregdetit në Seman të Fierit. Shkurt një "Dibër e mbytur" nga ngritja e një dige në Skavicë të Kukësit dhe nga uji i amullit i liqenit që formohet nga Reçi e deri në Gjoricë, në luginën më pjellore të maleve të Shqipërisë është një "Dibër e vdekur".

Kur dy vjet të shkuara në kundërshtim të një tenderi të hapur nga qeveria Berisha II për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës dola publikisht në disa gazeta me shkrimin "Dibra po mbytet, ku janë dibranët?" kisha ndjenjën e sigurisë se Dibra dhe dibranët do të flisnin, madje të revoltuar. Kisha ndjenjën e sigurisë se intelektualët dhe të zgjedhurit në kuvend dhe në piramidën e pushtetit lokal, të majtë e të djathtë, do të dilnin për pak kohë nga "prehri" i partive të tyre për të bashkuar zërin në pyetjen: "A do të mbytet dhe pse duhet mbytur Dibra?". E kisha këtë ndjenjë sepse Dibra në fund të fundit nuk është krijesë e asnjë partie politike të "kohës sonë" dhe të "asnjë kohe" por është krijesë e natyrës, e Zotit.

U zhgënjeva në ekstrem. Asnjë dibran i shtetit dhe i pushtetit, i djathtë apo i majtë, nuk doli nga "prehri" i partisë së tij për të thënë fjalën e vet, pro ose kundër.

Por ndërsa u zhgënjeva nga dibranët, u ftoha nga dëbora dhe akulli i qëndrimeve të tyre, më ngrohu, madje më solli "pranverë" një zë jashtë Dibre, një njeri që nuk ishte dibran, një jugor, Xhemal Mato. Po përcjell reagimin e tij publik:

Përsëhendetje Abdurahim,

E lexova shkrimin tuaj dhe problemi mu duk shumë i rëndësishëm dhe kompleks. Unë vetë mësova shumë gjëra dhe kuptova që pak e njoh problematikën që do të sjellë ndërtimi i Skavicës. Mendoj se intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt (është e drejta e tyre dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës). Gjithashtu me ligj ata kanë të drejtë ta anulojnë, nëse nuk janë dakord dhe argumentojnë ato që ju përmendni me të drejtë. Kjo është rruga ligjore por si e dini dhe ju, ligjet shpërfillen në këtë drejtim

Rrjedha e lumit Drini i Zi nga Ura e Spiles nën hidrocentralin e Dibrës së Madhe e deri në derdhje në det ka nevojë për "mendjen e shkencëtarëve", e politikës dhe e politikanëve, e pushtetarëve dhe shtetarëve në alternativat e "majës së piramidës".

# Skavica, a i bën dëm Dibrës?

## Edhe njëherë: ku janë dibranët, ku janë intelektualët, ekologët, historianët, arkeologët e ndershëm shqiptarë? A ka alternativë tjetër përveç alternativës së mbytjes së Dibrës?

në Shqipëri, kështu që ngel hapi i dytë gjyqi, i cili gjithashtu nuk fitohet kollaj dhe s'e merr përsipër ta bëjë një grup i pa bashkuar, shpesh i pamotivuar në ndërgjegje. Së fundi është gjyqi publik të cilin ju jeni duke e bërë por këtu të gjithë ata që janë dakord me ju duhet ta bëjnë dhe unë tashmë rreshtohem pas jush.

Te fala, Xhemali  
\*\*\*

Për hir të së vërtetës do të vlerësoja reagimin e Bujar Karoshit të gazetës "Rruga e Arbrit" në "Pazari" dhe në "Shënimin e redaksisë" ku thotë:

"Letra e hapur e bashkëpunëtorit tonë, Abdurahim Ashiku, drejtuar intelektualëve dibranë, dhe në veçanti, Presidentit të shoqatës "Për mbrojtjen e pellgut të Drinit të Zi", trajton një problem shumë madhor për Dibrën dhe dibranët. Problemi nuk është vetëm lokal, është gjithëkombëtar. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se Hidrocentrali i Skavicës është një vepër "madhore", por ajo nuk duhet të kthehet një vepër "mizore"..."


Pas kësaj do të vinte vetëm një reagim - kronikë nga një gazetar matjan, Hasan Pasha. Po e përcjellim atë:

Qindra banorë të Dibrës, kryesisht nga fshatrat e komunës Fushë-Çidhën u mblodhën në një protestë kundër ndërtimit të HEC-it të Skavicës. Ata mbanin në duar pankarta ku shkruhej: "Dibra mbytet", "Ndal projektin italian", "Jo hidrocentralit të Skavicës", etj. Në krye të protestës qëndronin drejtuesit e shoqatës "Drini i Zi" Nazmi Driza, Sadin Përnezha, drejtues të komunës Fushë-Çidhën, banorë të fshatrave që përmythen, qytetarë të Peshkopisë etj... Në krah të protestuesve dibranë ndodhej edhe historiani Ali Hoxha, i cili hapi mitingun dhe tha se "ndërtimi i HEC të Skavicës mbytet një qytetërim të lashtë dhe të njohur në trevat shqiptare. Ndërtimi i Skavicës sjell fshehjen nën ujë të historisë së një treve nga më të lashtat dhe nga më krenaret, një trevë që ka nxjerrë heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin -

Skënderbeun, i cili, nga 26 betejat fitoresh të mëdha me zë në historinë e Shqipërisë dhe të Evropës kundër dy sulltanëve osmanlinj, 19 i ka zhvilluar me dibranët dhe në tokën dibrane"

Në tetor të vitit 2009 vjen një reagim tjetër, replikë ndaj një shkrimi të Prof.dr. Pandi Stradobërdha, Niko Pana e Alfred Frashri botuar në gazetën "Republika" me titull "Lëreni të bukur luginën e Drinit të Zi" të Murat Koltrakës. Është i gjatë reagimi, me analizë ekonomike, historike, gjeografike, shoqërore, me shifra e fakte që nuk e di pse nuk e ka mbështetur asnjë dibranë në hapësirën kohore të katër muajve, nuk e ka thënë fjalën asnjë kuvendar-deputet (nga e majta apo nga e djathta), asnjë pushtetar lart e poshtë, i pozitës apo opozitës (në prefekturë, në bashki, në komuna), asnjë intelektual në Dibër, në Tiranë apo një hapësirë më të madhe gjeografike.

Megjithatë, në respekt intelektual ndaj z. Koltraka, po shkëpus disa



shqetësimi të mëdha të tij, shqetësime që janë edhe të miat, edhe të mbarë dibranëve:

Ai u drejtohet Prof.dr. Pandi Stradobërdha, Niko Pano e Alfred Frashri:

Për rajonin që përmythen, pasojat që i vijnë atij, ju nuk e keni vënë lapsin në letër, pra nuk u interesojnë. Kjo do të thotë, të shikosh vetëm njëherë anë të medaljes, ose është si të bisedosh me vetveten...

Skavica përmytet luginën e Drinit të Zi në një gjatësi prej 75 km, nga Kukësi në veri, deri në kufi me Maqedoninë në jug, asgjëson potenciale të mëdha etnike, ekonomike, kulturore, historike, ekologjike, të cilat ju nuk i keni studiuar...

Dibra një etni, një gjak, një gjuhë, me të njëjtat tradita e zakone, me një histori të përbashkët, më 1913 u nda më dysh. Ata që e ndanë, nuk përfillën asnjë parim për vendosje, por vulosën vendimin duke marrë me vete njollën e turpit gjatë tërë historisë. Dibra e Epërme padrejtësisht u kaloi sllavëve, Dibra e Poshtme i mbeti Shqipërisë. Kjo gjysmë e territoreve dibrane që i mbeti Shqipërisë, të nderuar zotërinj, a duhet të ndahet dhe një herë nga jugu në veri sipas idesë suaj? Nëse ndodh kështu, Dibra e Poshtme shpërbëhet.

Ndërtimi i Skavicës të nderuar zotërinj, zhduk nga harta e Shqipërisë një nga "Perlat më të bukura e më të pasura në tërë territoret shqiptare. Ideja juaj detyron mijëra banorë të lënë trojet e tyre etnike, pa qenë faktorë, ndërpret jetën njerëzore në këtë

salla e turbinave futej 30 metro poshtë, duke realizuar idenë tonë të parë me digë 190 metro të lartë. Ky variant mbyste 62 km<sup>2</sup> tokë dhe s'postonte 40 mijë banorë.

Pyetja ime ishte: A ishte dakord Qeveria me spostimin e banorëve? Përgjigja ishte që sigurisht jo.

Unë iu përgjigja se e ka një zgjidhje, e cila është vetëm nëse kthehet sistemi i vjetër që mbyti një qytet si Kukësi.

Një problem që e ngre një specialist që sheh përtej teknikës, që e "zbrat në tokë problemin" ashtu siç jam munduar ta zbrat edhe unë në shkrimin "Po mbytet Dibra, ku janë dibranët?", ashtu siç e zbrat z. Koltraka në shkrimin replikë: "Lëreni luginën e Drinit të Zi, të bukur siç e ka dhënë Zoti".

E dini pse diktatura nuk e ndërtoi Skavicën? Një "lajm i brendshëm" i asaj kohe e lidhte me strategjinë, me faktin se "liqeni i Skavicës" e ndante përfundimisht Dibrën, e bënte "kafshatë të lehtë për sërbo-sllavinë", e mbyste historinë e saj, i mbyste të 18 nga 25 betejat fitimtare të Skënderbeut që u zhvilluan në Dibër, mbyste arkeologjinë tërësisht të pa prekur të saj, mbyste ato burime bujqësore e blegtorale që nuk i ka pothuajse asnjë luginë në Shqipëri.

Profesori i nderuar Pinguli flet për 62 kilometra katrorë tokë të mbytur e 40 mijë banorë të shpërngulur. Në Shkodër kishim 11.400 hektarë dhe 2649 shtëpi të përmytura, një popullsi afro katër herë më të vogël se sa popullsia në pellgun mbytës të Dibrës, një popullsi që do të kërkonte 62 kilometra katrorë tokë për tu shpërngulur, që do të kërkonte rreth 8 mijë banesa të ndërtaura...

A është e mundur një shpërngulje e tillë kaq masive në kushtet kur në Shqipëri nuk ka qoftë edhe një pëllëmbë tokë të lirë?

Kësaj pyetjeje nuk i përgjigjet as politika dhe as specialistët. E vetmja fjalë e tyre është: Të mbytet Dibra!

I citova këto për arsye se po të ndodhte një gjë e tillë, po të ishte ngritur lart zëri i dibranëve mbarë, pas "Përmytjes së Shkodrës" nuk do të fliste njeri për "Mbytjen e Dibrës".

Duke theksuar solemnisht si njeri me ndërgjegje e shpirt human se ndiej dhimbje të madhe për atë që i ndodhi Shkodrës, për atë përmytje të pashembullt pre e "natyrës qorre" dhe e "njeriut me sy, veshë e shpirt" dhe se jam me ta në këtë fatkeqësi dua që atë që i erdhi nga "natyra dhe njeriu" Shkodrës dhe Shkodranëve të mos i vijë nga "njeriu, dhe vetëm nga njeriu" Dibrës.

Rrjedha e lumit Drini i Zi nga Ura e Spiles nën hidrocentralin e Dibrës së Madhe e deri në derdhje në det ka nevojë për "mendjen e shkencëtarëve" e jo "mendjen e magjarëve", e politikës dhe e politikanëve, e pushtetarëve dhe shtetarëve në alternativat e "majës së piramidës".

Para se të mbytet Dibra duhet të "mbytet" mendimi i "njëshit", mendimi i "njërës anë të medaljes". Luginë e Dibrës, mbytja e saj, nga sa shoh e dëgjoj nga larg, shihet si "alternativa e hurdhës" që mbledh ujë

për të "ujitur turbinat e fitimit kapitalist". Dibranët e njohin "përvojën e hurdhës", e kanë praktikuar në mijëra vjet të ekzistencës dhe të rezistencës së tyre. E kanë praktikuar për të ujitur misrin, jonxhën e bimët e tjera verës së thatë. Hurdhat e ujit pranë çdo burimi për të ujitur "dy pashë tokë" janë në kolonën vertikale të ekzistencës dhe rezistencës së saj.

Dhe mos kujtoni se ata nuk i duan "hurdhat moderne". I duan, madje unë do të thosha ti dëgjoni ku i duan dhe pse i duan.

Studiojeni një variant të tyre, atë të "hurdhave" mbi degëzimet e Drinit të Zi. Studiojeni sa "hurda" e poshtë tyre sa turbina e stacione shpërndarës energjie elektrike mund të ngrihen në zbritjen e Mallës së Lurës nga Krej Lura e deri në Drinin e Zi mbi Skavicë. Ngjituni më lart e bëni të njëjtën gjë mbi Setë, Murrë, Zallin e Okshunit, mbi Veleshicë, Proin e Gramës e vende të tjera. Mbi këto degë të Drinit të Zi do të kishim dhjetëra "hurda" e dhjetëra hidrocentrale ujëmbajtja dhe fuqia energjetike e të cilëve në mos qoftë e barbartë me "hurdhën e vdekjes" që vjen nga Skavica ma do mendja se i afrohet asaj. Këto "hurda" mendja më shkon se do të ishin po aq të bukura sa edhe liqenit e Lurës apo të Kacnisë. Për më tepër do të ishin vende pune të përhershme për mijëra dibranë por edhe stacione të gjerë të rritjes së troftës aq të shijshme në ujërat e pastra të burimeve mbushëse të tyre. Brezit që do të vijë do të desha që pas digës së Setës, diku në Grykën e Gjalicave të Lurës, të gjenin një "mol gondolash" që do ti përcillnin midis asaj pamje mahnitëse të Gjalicave, atij "tuneli" shpatësh të thepisura malesh nga kalon "kanali i piketuar me pushkën e Gani Tuçepit" i Çidhnës tek burime e Setës në Gurë Lurë e prej andej, me teleferik do ti ngjisin në bregun e Liqenit të Luleve e në Fushën e Pelave...

Poshtë Setës, poshtë Murrës e degëzimeve të tjera të Drinit të Zi do të gjelbëronin me bimë arash, perime, vreshta e drufrutorë fushat nga Reçi, në Zall-Dardhë, Fushë të Çidhnës, Kishavec, Muhurr, Brezhdan, Luzni, Gjoricë, hambari i Dibrës dhe i dibranëve në shekuj. Por jo vetëm i dibranëve. Flitet shumë për agro-turizëm. Nuk ma merr mendja që të ketë ndonjë trevë shqiptare ku bujqësia dhe turizmi të jenë kaq pranë e kaq të lexueshëm se sa në Luginën e Drinit të Zi krahëhapur me "Nëntë Malet" në përëndim dhe me Korabin, Hynoshkën e deri me Majën e Zylit në Gollobordë në lindje. Po të dijë ndokush ndonjë vend që e bashkon më mirë bujqësinë me turizmin, ndonjë vend agroturist, kuptohet pa mbytjen e Dibrës, le ta thotë.

Unë e shoh se të dy krahët e politikës shqiptare janë për mbytjen e Dibrës "me variant të plotë apo të shkurtuar" siç deklarojnë. Një gjë u them, para se ta bëni këtë studiojeni edhe këshillën që jepte shekuj më parë A. Linkoln: "Lëreni luginën e Kolorados, të bukur ashtu siç e ka dhënë Zoti". Studiojeni edhe alternativën dibrane: "Na e lini Dibërën siç na e ka lënë Zoti", "Na lini të gjallë në tokën që na e ka falë Zoti". Pyeteni Dibërën për të mos pasur telashe me të!

Për kontakt me autorin e shkrimit mund të shkruani në <a\_ashiku@yahoo.gr>

\*Titulli është i redaksisë

Në kushtet e relievit të Shqipërisë me interesimin e madh të komuniteteve për të administruar burimet natyrore është e mundur që Shqipëria të përfshijë të gjithë basenin ujëmbledhës të Drinit në projekte për shërbime të pagueshme mjedisore, përmirësimin e përdorimit të tokës veshjes së saj dhe pakësimit të erozionit.

Nga: XHEMAL MATO  
HAKI KOLA

Kushdo që udhëton për të shkuar te liqeni i Komanit, gjatë rrugës vë re se ura e lumit të Gostimes, moshatore me hidrocentralin e Vaut të Dejës është mbuluar nga prurjet e Drinit. Për këtë arsye ajo u zëvendësua me një urë të re në vitin 2004.

Kur u krijuan 3 liqenet e Drinit nga ndërtimi i digave, alpet përreth dhe pjesët e kodrave e maleve të Pukës ishin të veshura me pyje të dendura.

Sot pjesa e alpeve që zbret deri te lugina e Drinit (në sektorin nga Fierza deri në Vaun e Dejës), dhe që i ndan Alpet nga Malësia e Pukës, është kthyer në një zonë krejt të zhveshur. Zjarret dhe prerjet e kanë shkatërruar atë si në pellgun e Tropojës ashtu edhe në luginën e rrjedhjes së poshtme të Valbonës.

Tani nga këto terrere të alpeve që arrijnë një sipërfaqe prej 2200 km katrorët, erozioni po rrëmben gjithë tokën dhe inertet. Erozioni e hollon tokën shqiptare për çdo vit me rreth 3mm (nëse shpërndahet uniformisht në gjithë sipërfaqen e vendit).

Ndërsa në zonat tona malore shpyllëzimi nxjerr në pah terrenin shkëmbor të ashpër dhe të thyer të këtyre mjedisve duke shpejtuar dhe zmadhuar erozionin e tyre dhe lëvizjen mazive të dherave.

Kur terrenet nuk kanë me pyje, gëmusha apo tokë me bar, edhe shiu më i vogël që bie sipër tyre, kthehet në vërshime të shpejta e të fuqishme, që marrin me vete shumë materiale sipërfaqësore.


Imagjinoni se ç'ndodh po të hedhim mbi tapet ujën e një gotë dhe pastaj po ketë sasi uji ta hedhim mbi dyshemenë me pllaka (pra, pa tapet). Imagjinoni tani tapetin natyral (pyjet, shkurret dhe token) që veshnin dikur terrenet rrotull baseneve të Drinit dhe lumenjve që furnizojnë atë. Kur pyjet i presim, i djegim dhe tokën e shpëllajmë, çdo të ndodhë me ujën e rënë nga qielli?

I tërë uji i shiut apo borës së shkërrit, shumë shpejt do të kthehet në vërshime të furishme duke përfunduar në liqenet ujëmbledhëse, duke marrë me vete dhe mijëra ton tokë dhe inerte.

Në këtë rast niveli i liqeneve do të ngrihet shumë më shpejt se më parë jo vetëm nga shpejtësia e lëvizjes së ujit, por dhe për faktin se fundi i liqeneve tashmë është mbushur me inertet e sjella gjatë 30 vjetëve. Mendoni një gotë e mbushur përgjysmë me rërë që mbushet edhe më pak ujë, pra dhe me shpejt se gota që do ishte e gjithë bosh.

Drini, lumi më i gjatë i trojeve tona, ngjan me një zinxhir që lidh 4 shtete dhe 4 ujëmbledhëse të madhe, Prespën, Ohrin, Shkodrën e Adriatikun. Dikur Drini e takonte Adriatikun afër Lezhës, por një përmbajtje në shekullin e 19 e bëri të ndërrojë shtratin drejt lumit të Bunës duke shtuar ndikimin në Liqenin e Shkodrës.

Liqeni i Fierzës u bë fakt në vitin 1978 duke u shtrirë në rreth 70 km gjatësi e duke mbuluar dhe vendformimin e vet Drinit, diku në Kukës, ku bashkohen dy degë krye-



Pamje nga Lugina e Drinit të Zi. Foto: B. Karoshi

## Kambanat bien për reflektim

sore të tij: Drini i bardh që buron afër Pejës dhe Drini i Zi që rrjedh nga liqeni i Ohrit në qytetin e Strugës. Rrugës i shtohet dhe lumi Radika (Maqedoni) të tjerë në Librazhd, në Bulqizë, Peshkopi e Kukës. Sipas literaturës, prurja mesatare vjetore e Drinit arrin 352 m3/sek, kurse maksimalja e regjistruar është mbi 5100 m3/sek.

Drini i sjell liqenit ujën, i cili mbart me vete gjithë gabimet mjedisore të bëra nga çdo shtet i zinxhirit të tij. Por, për ne ai mbart dhe pasuri e begati (mbi një milion euro në ditët me kapacitet të plotë).

Kur ishin pa u prerë pyjet e Bulqizës, Zerqanit, Selishtës, Lurës, Arnit, Gjallicës e Pukës apo gjithë mbulesa pyjore e Alpeve, përllogaritja tregonte që Drini përcillte në detin Adriatik rreth 250 mijë tonë inerte në vit, apo të kthyer në volum rreth 180 mijë m3.

Është vështirë të gjenden të dhëna speciale pas prerjes e djegies përfundimtare të pyjeve në 20 vitet e fundit. Te rezervuarët e ujitjes specialistet i llogarisin mbushjet mesatarisht me 1.5-2 për qind në vit.

Nuk dihet nëse kjo mund të zbatohet për Drinin që përbën shumatorën e erozionit. Nëse thjesht ndërtojmë një skenar të supozuar për 30 vjet sipas këtyre koeficienteve teknike duhet të jetë mbushur rreth 45 e rezervuarit, apo e përkthyer në volumin e liqenit me kapacitet maksi-

mal 3.2 miliard metër kub, i takon që rreth 1.9 miliard metër kub të jenë mbushje të ngurta.

(Pra më shumë se gjysma!!) Kjo duket e pabesueshme, por nëse kujtojmë traqet që para disa vitesh hasi në inerte në fundin e liqenit të Komanit, ia vlen të mendohemi e të reflektojmë se sa vend kanë zënë inertet e mbushjet liqenit, dhe përse ai s'po arrin të kontrollohet e po i shpeshton përmbytjet.

Ish-Instituti i Studimit të Tokave, konfirmon që për çdo vit humbasin deri 40 tonë shtrese tokësore për hektar në shkallë vendi, dhe në vende të ndjeshme karshi erozionit deri 100 ton/ha, nëse zbatohet në sipërfaqen prej 1.182.900 ha që është sipërfaqja e basenit të Fierzës, rezulton një mbushje e liqenit nga 40 -100 milionë tonë në vit.

Përgjatë 30 vjetëve të jetës së liqenit duket se e kanë kaluar sasinë prej 1 miliard metër kub dhera që janë gërruar në liqen Pra, ujit në nivel normal tashmë i ka mbetur më pak se gjysma e sipërme e volumit të liqenit që do të thotë se ai mbushet me ujë më shpejt dhe ky ujë mbaron me shpejt.

Në kuadrin e ndryshime klimatike është filluar një projekt GEF në luginën e Drini, fokusuar kryesisht në derdhjen e tij. Duket se projekti ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve, si dhe për monitorimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Jo vetëm ky projekt nuk ka parash-

ikuar këtë problem, por deri tani nuk ka asnjë projekt për ruajtjen e ujit nëpërmjet trajtimit të tokës, veshjen me bimësi të zonës dhe pakësimin e erozionit duke shtuar burimet ujore nga Prespa, Kosova e gjithë pjesën tjetër të basenit të Drinit.

Shqipëria ka arritur të zërë një treg modest për të shitur kreditë karboni, si shpërblim për rehabilitimin e bimësisë ekzistuese (!), projekt i asistuar nga Banka Botërore e zbatuar nga Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me 24 komuna të vendit.

Me ritmet e mbushjes duket se ditët e kaskadës së Drinit janë të numëruara. Në shpatet ku janë kapur digat, toka duket tepër e lodhur. Ajo ka humbur jo vetëm drurët e barin, por në një pjesë të madhe edhe mbulesën e saj natyrore, pra është kthyer si një kafshë që i kanë hequr lëkuren e mezi mbijeton.

Kambanat bien për reflektim. Në kushtet e relievit të Shqipërisë me interesimin e madh të komuniteteve për të administruar burimet natyrore është e mundur që Shqipëria të përfshijë të gjithë basenin ujëmbledhës të Drinit në projekte për shërbime të pagueshme mjedisore me objektiv shtimin e burimeve ujore, përmirësimin e përdorimit të tokës veshjes së saj dhe pakësimit të erozionit.

Një grup specialistesh në bashkëpunim me ambasadën gjermane organizuan para një viti një konferencë kombëtare ku është trajtuar

opinion

Me ritmet e mbushjes duket se ditët e kaskadës së Drinit janë të numëruara. Në shpatet ku janë kapur digat, toka duket tepër e lodhur. Ajo ka humbur jo vetëm drurët e barin, por në një pjesë të madhe edhe mbulesën e saj natyrore, pra është kthyer si një kafshë që i kanë hequr lëkuren e mezi mbijeton.

problemi i degradimit të tokës e janë propozuar alternativa për zgjidhje.

Gjetjet kryesore janë të sistemuara edhe në një libër. Kjo ishte aq pak sa qeveria gati nuk e vuri re. Kambanat e përmbytjes na thërrasin të mos luajmë strucin, por të vlerësohet me seriozitet statusi aktual i mbushjes së liqeneve, që duket punë më e lehtë se sa llogaritja e ndikimit të ndryshimeve klimatike, që bëhet atje ku ujët mbaron funksionin e derdhet, si dhe t'u kërkohet donatorëve aktualë, veçanërisht Bankës Botërore, PNUDIT, SIDES partneritet për vepër.

Përvoja e punës me ta është krijuar. Kërkesa për ndihmë e projekte donatorëve duhet shoqëruar me mirëkuptim për reforma institucionale për të shtuar numrin e dijet në shërbimin pyjor, për të rritur vlerat e tokës e ujit dhe për të ndarë me komunitetin ligjërish të drejtat mbi tokat e basenit.

Vete uji i liqenit i miradministruar mund të shërbejë si kontribut investimi, pasi kur mirëpërdoret është një miniere floriri. Kjo do të ishte më mirë se teatri i fadromave që luftojnë për të zgjidhur problemin me argjintura apo duke thelluar Bunën (!) Përmbytjet dhe agonia e gjiganteve tanë të energjetikës tashmë kanë filluar dhe kërkohet urgjentisht ndërhyrje të mëdha sot për të arritur ta kontrollojmë të paktën pas 10 vjetësh.



merr kopjen tënde

Të gjithë duhet të organizohemi dhe me kontributet tona në para ose artikuj tjerë të shprehim solidaritetin tonë me shkodranët, të cilët nga përmytjet janë duke përjetuar ditët më të vështira

DIBËR E MADHE – PAS 19 VITEVE TË DEMOKRACISË

# Do të hiqen emërtimet serbosllave

Nizamedin Papraniku, kryetar aktual i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe lidhur me këtë çështje, deklaroi se, " në agjendën e punës së Këshillit për këtë vit janë edhe emërtimet e rrugëve, shesheve dhe urave. Synimi ynë është që të vendosen emërtime të personaliteteve meritore sipas bëmave të tyre dhe në këto emërtime të përfshihen të gjitha komunitetet. Ky propozim do të miratohet edhe në Komisionin për marrëdhënie me etnitë. Ky propozim pastaj duhet të votohet në njërin nga mbledhjet e Këshillit të Komunës sipas sistemit të Badinterit".

Ndryshe në Komunën e Dibrës së Madhe përkundër 19 viteve të demokracisë ende figurojnë emërtimet serbosllave të rrugëve dhe shumë rrugë të emëruara me numra. Vendimi i miratuar i ish Këshillit të Komunës së Dibrës së Madhe i datës 17.07.2002, për ndryshimin e emrave të 6 lagjeve, 50 rrugëve, shesheve dhe 5 urave në Komunën e Dibrës së Madhe ka mbetur ende pa u realizuar, për arsye të refuzimit të qeverisë së atyre viteve dhe ankesës së degës së VMRO-DPMNE në Dibër të Madhe, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë. Kjo e drejtë për ndryshimin e emërtimeve e fitoi në mbështetje të Ligjit për vetë administrim vendor, të botuar në Gazetën Zyrtare nr.5 të vitit 2002.

Ish KK i Dibrës së Madhe vendosi në vend të emërtimeve të rrugës "1 Maji", të jetë "Fuad Dibra", patriot dibran, i cili për çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris shpenzoi 500 mijë franga ari, në vend të emërtimeve "Petre Popovski", të jetë "Iljaz Pashë Dibra", kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në vend të emërtimeve të rrugës "APJ", të jetë "Selim Rusi", patriot dhe atdhetar dibran, në vend të emërtimeve



Në foto: Nizamedin Papraniku.

"Boris Kidriç", të jetë "Said Najdeni", iluminist i shquar dibran dhe mbarëkombëtar, në vend të emërtimeve "Atanas Iliq", të jetë "Kongresi i Dibrës", i mbajtur më 23 korrik 1909 ku morën pjesë përfaqësues të vilajeteve të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, që kishte karakter të theksuar kombëtar shqiptar për përdorimin e gjuhës shqipe dhe për realizimin e pavarësisë së Shqipërisë, në vend të emërtimeve "Velko Vllahoviq", të jetë "Kongresi Manastirit", që njihet për karakterin mbarëkombëtar shqiptar. U vendos emërtimi i Sheshit "Skenderbej", sepse Skenderbeu, nga 24 betejat e tij të lavdishme 19 i zhvilloi në trevat e Krahinës së Dibrës në vend të emërtimeve të rrugës "Bratstvo Edinstvo", u vendos të jetë "Haxhi Vehbi Dibra" - delegat i Dibrës në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë në vitin 1912, në vend të emërtimeve të rrugës "Nikolla Karev", të jetë "Elez Isufi", patriot shquar në luftërat kundër okupuesve serbë

në vitet 1912-1921. Në këtë listë ishin edhe shumë personalitete tjera të shquara dibrane si, Ismail Pashë Qoku, Sherif Langu, Ramiz Daci, Josif Bageri, Sefedin Pustina, Ramiz Varvarica, Mojsi Golemi, Dr. Nexhat Agolli, Edip Tërshana, Xhafer Kodra etj., si edhe ngjarja e rëndësishme historike "Kuvendi i Qenanicës", ku përveç tjerash për një ditë janë falur 10 mijë gjaqe.

Me këtë vendim të ish KK në Dibër u propozuan edhe ndryshimet dhe emërtimet e lagjeve, kështu që lagjet ("Venec" I dhe "Venec" II), do të quheshin "Uraniku" dhe "Tylbe", ("Varoshi") "Penestia", ("Buduleci") "Burimi", ("Kojnara") "Ballkuqi", ("Ura e Rajçicës") do të quhej "Ura Iliria", ndërsa ("Ura e Mellniçanit") "Ura e Radikës" etj. Shumë rrugë që ishin vetëm me numra do të pagëzoheshin me emra personalitetesh shqiptar.

Të shpresojmë që emërtimet e reja të zbatohen gjatë këtij viti.

Rexhep TORTE

DIBËR E MADHE - SOLIDARITET ME POPULLATËN E PËRMYTUR TË SHKODRËS

# Ndihmë për zonën e përmytur

Nizamedin Papraniku, kryetar i Këshillit të Komunës së Dibrës të Madhe në takimin me gazetarët, theksoi se, " Në emër të kryetarit të komunës i cili ndodhet për vizitë në SHBA dhe të Këshillit Komunal apeloj te qytetarët, firmat dhe biznesmenët që sipas mundësive të tyre të grumbullojmë mjete financiare, veshmbathje dhe artikuj ushqimorë për vëllezërit tanë në zonën e përmytur të Shkodrës, të cilët këtyre ditëve përjetojnë çaste shumë të vështira në përballimin e kësaj fatkeqësie natyrore. Pushteti vendor ka ndarë 2 mijë euro ndihma, ndërsa në Bankën Ekonomike -Filiali në Dibër të Madhe është hapur xhirollogaria numër 200001115885373 për të gjithë ata që dëshirojnë të dërgojnë mjete financiare. Veshmbathje dhe artikujt ushqimorë mund të dërgohen nëpërmjet Kryqit të Kuq të Dibrës të Madhe. Shpresoj si gjithnjë dibranët do ta dëshmojnë gatishmërinë e tyre dhe shpirtin solidar për të përballuar këtë fatkeqësi në zonën e Shkodrës".

Ndërkaq edhe Myftinia e Dibrës së Madhe duke iu përgjigjur apelit të BIM-së në të gjitha xhamitë që i administron në Komunën e Dibrës të Madhe, të Qendrës së Zhupës dhe të Komunës Mavrovë-Rostushë, ditën e faljes së xhumasë dhe ditëve që vijojnë do të apelojë te popullata dibrane për të ndihmuar popullatën e përmytur të Shkodrës.

Mr. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës së Madhe para gazetarëve, tha se, "marrëdhëniet vëllazërore mes Dibrës së Madhe dhe Shkodrës sipas bëmave historike janë shekullore. Të gjithë duhet të organizohemi dhe me kontributet tona në para ose artikuj tjerë të shprehim solidaritetin tonë me shkodranët, të cilët nga përmytjet janë duke përjetuar ditët më të vështira. Në këtë kuadër bujqit dibranë arrihen të grumbullojnë 5 kamionë me bazë ushqimore jonxhë dhe i nisëm në drejtim të Shkodrës si ndihmë fermerëve shkodranë për bagëtitë e tyre, duke shprehur gatishmërinë se do të vazhdojnë edhe më tutje me këtë lloj ndihme."

Rexhep TORTE



# Dibrani që kandidon për në Kongresin Amerikan

Fare rastësisht në postën time elektronike më erdhi një informacion nga Lulzim Haxhiu se dibrani Emin Egriu kandidonte për kongresmen në Kongresin Amerikan. Ishte vërtet një surprizë kjo për ne por nga që nuk kishim informacion për jetën e tij përsëri falë zotit Lulzim Haxhiu u informuam më shumë. Dinim fare pak për këtë familje të shquar dhe patriotike dibrane e kjo nga Prof. Ibrahim Egriu. Po në fakt kush është Emin Egriu. Lindi në Dibër në vitin 1962. Në vitin 1969 largohet nga Dibra ku në fillim ngulen në Itali e në vitin 1970 shkon në Amerikë ku dhe jetojnë akoma. Babai i tij Dini ra në sy nga autoritetet vendase se tregonte rrezikshmëri për qeverinë e Beogradit. Ai në fakt doli hapur në mbrojtje të të drejtave të popullit kosovar. Kështu që kushtet e emigrimit kjo familje patriotike ia diktoi vetë koha. Edhe pse në kontinentin e largët Din Egriu, bashkë me Prof Ibrahim Egriun nuk pushuan kurrë dhe asnjë çast për çështjen kombëtare dhe të drejtave të kosovarëve. Kështu të dy së bashku ishin organiza-



**Emini ka punuar gjatë me Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe Këshillin Nacional Shqiptaro-Amerikan, për sesbilizimin e çështjes shqiptare. Mbështetësit e tij janë të bindur se dibrani model në Buffalo të Nju Jorkut tashmë i është hapur rruga drejt Shtëpisë së Bardhë.**

Në foto: Emin Egriu dhe Wesli Klark

torët kryesor të demonstratës së madhe që u zhvillua në qytetin e Nju Jorkut në vitin 1981, kundër dhunës dhe reprezaljeve që ushtrohej ndaj popullit kosovar nga pushteti komunist jugosllav. Vëllai i tij Naxhi Egriu në vitin 1999 e braktisi emigrimin dhe iu bashkua UÇK-së në batalionin "Atlantiku" duke u bërë kështu dëshmmori parë përtej oqeanit. Emni edhe pse i rritur në një mjedis larg

vendlindjes ai ka mbetur gjithmonë mjaft i afërt me vendlindjen, me Dibrën e tij të shtrenjtë e të dashur. E këtë dashuri e nxiti vazhdimisht tek fëmijët e tij i cili ka katër fëmijë, dy djem e dy vajza. Emni është diplomuar për shkencat politike por shumë vite ka punuar edhe arsimtar në Amerikë nga vitet 2000-2009. Jo vetëm intelektual i kompletuar por dhe një biznesmen i njohur tashmë

në SHBA në fushën e ndërtimeve, edhe një bashkëshort shembullor. Firma e tij e ndërtimit merret kryesisht me ndërtime kisha, shtëpi banimi, vila, dyqane etj por është dhe një konsulent për ligjet në ndërtim të cilat i njeh fare mirë. Aktiviteti i tij patriotik e atdhetar është i madh, ai ka rënë tashmë në sy nga komuniteti shqiptar që jeton prej vitesh në SHBA. Në vitin 1999 Emin Egriu ishte i pari që priti refugjatët kosovar duke u bërë si të thuash promotor i kësaj lëvizje refugjatësh. U interesua vetë duke i strehuar dhe siguruar ushqim e veshmbathje. Jo vetëm kaq por ai disa herë mori kontakte me kongresmen amerikan për të drejtat e shqiptarëve. Takimet më të shpeshta i ka pasur për këtë problem me Diugardin por dhe me vetë gjeneralin Uesli Klark ku sot në arkivin e tij familjar disponon një sërë fotografii të ndryshme. Për zgjedhjet e vitit 2010 Emin Egriu kandidon në distriktin 28 për në Kongresin Amerikan nga partia demokratike duke u bërë kështu dibrani i parë që mund të shkel në Shtëpinë e Bardhë. Pse

jo, të gjitha shanset i ka, në radhë të parë është një figurë e njohur në SHBA si intelektual, biznesmen i sukseshëm e taksapaguesi më i rregullt por ka mbështetjen e madhe të komunitetit shqiptar në Amerikë. Platforma e tij është e qartë: Punë për të gjithë duke krijuar kështu vende pune, taksa të ulta, kujdes shëndetësor të përballeshëm, kufizim të shpenzimeve qeveritare. Dhe Emni e ka treguar se mban premtimet. Në kompaninë e tij ka punësuar mjaft shqiptar të shtresave të ulëta. Emni asnjëherë nuk ka rreshtur së foluri për çështjen shqiptare. Ai u bë një zë i fuqishëm për luftën që bëhej në Kosovë, dhe ky zë u dëgjua deri në OKB. Emni ka punuar gjatë me Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe Këshillin Nacional Shqiptaro-Amerikan, për sesbilizimin e çështjes shqiptare. Tani kryesisht është përqëndruar në zonën e Nju Jorkut përëndimor. Jo vetëm Emni por dhe të gjithë mbështetësit e tij janë të bindur se dibrani model në Buffalo të Nju Jorkut tashmë i është hapur rruga drejt Shtëpisë së Bardhë. / Sh.S.

Është momenti më i favorshëm dhe një shancë që nuk duhet humbur për afaristët dhe biznesment dibranë në Amerikë, që të vijnë e të investojnë tash në Dibër të Madhe.

intervistë

# Paçuku: Investimet nga diaspora janë një rast i mirë, që nuk duhet ta humbë asnjë dibran

Me Petrit Paçukun - Drejtori i Zyrës së Urbanistikës në Dibër të Madhe

Nga: BEQIR SINA, New York

**Petrit Paçuku - Drejtori i Zyrës së Urbanistikës në Dibër të Madhe, qytet që ka numërin më të madh të emigrantëve shqiptarë, në Nju Jork - Staten Island ( rreth 15 mijë dibranë), ndodhej këto ditë për vizitë private në SHBA- Ai thotë se ka shfrytëzuar këtë vizitë, të zhvillojë takime me afaristë e biznesmen dibranë në SHBA-së, që të nxisë dhe t'u bëjë thirrje atyre të venë e të investojnë në qytetin e tyre, pasi është momenti dhe shanci më i favorshëm. "Një rast i mirë, siç, i tha gazetës tonë, Paçuku, që nuk duhet t'a humb asnjë dibranë, sot". Por për drejtorin e Urbanistikës në Dibër të Madhe i rëndësishme është edhe bashkëpunimi me qytetarët dibranë, komunikimi i drejtpërdrejtë, transparent e korrekt me çdo qytetar. Sipas tij e rëndësishme është krijimi i planeve të reja urbanistike, sidomos ai i kompleksit turistik në bregun e liqenit të Dibrës së Madhe, dhe ish kazermet e Ushtrisë, të cilat do të orientojnë saktë, investoret, afaristët e biznesmenet. Në këtë intervistë ai flet edhe për mënyrë sesi i zgjidhë problemet e qytetarve Komuna e Dibrës së Madhe, dhe i përgjigjet disa pyetjeve të tjera.**



Foto: Argjent R. Kaba

**janë problemet me të cilat ballafaqoheni ju në komunë?**

Ky sektor në çdo komunë të botës është sektori më problematik. Pasi një nga aspektet e zhvillimit të komunave sot, anemban botës është gjithësesi urbanistika, infrastruktura dhe çështjet sociale. Dhe këto probleme janë në nivel të përgjithshëm, edhe për sa i përket Komunës së Dibrës së Madhe. E cila në shumë drejtime, ka punuar shumë të eliminojë sa më shumë problemet e krijuara, duke i hapur rrugën zhvillimit urbanistik e infrastrukturor.

Nga viti 2005, e deri sot që po flasim bashkë, pra deri në janar 2010, të gjitha problemet që kemi pasë kur e morëm ne Komunën, në administrim, kemi bërë ndryshime të mëdha në qytet. Me ardhjen e administratës së drejtuar nga kryetari i rimandatur z Argëtim Fida, gjërat në këtë drejtim kan ndryshuar thuajse 100 përqind. Ne kemi përfituar edhe nga ndrimi i ligjeve, nga kalimi i kompetencave prej nivelit qendror në atë lokal. Çdo problem që kan pasur qytetarët dibran, por edhe investitorët, janë zgjidhur në Komunën e Dibrës së Madhe. Deri tani nuk kemi asnjë rastë, që çështja tek shkuar deri në Shkup.

Faktikisht, problemi me ndarjen e pronave shtetore, është zgjidhur në bazë të një dokumentacioni që ka përgatitur komuna jonë. Më pasë këtë dokumentacion e kemi dërguar ne, në nivel republikan për miratim dhe kemi njoftuar se kur dhe ku do të bëhet shpallja e shitjes së saj me çmimin e caktuar nga administrata republikane- pra nga Shkupi. Duhet theksuar se problemet e pronës private në Dibër të Madhe, pothuajse nuk egzistojnë fare, pasi kjo çështje është zgjidhur me kohë në Dibër të Madhe.

**Për sa i përket investimeve nga diaspora - çfarë agazhimi keni gjetur nga vetë kurbetqarët dibranë?**

Tendecat, janë të tilla që bashkëatdhetarët tanë të kenë të gjitha mundësitë të vijnë e të investojnë. Pasi edhe për disaporën e investitorët nga diaspora, tani ka më shumë lehtësira. Për këtë qëllim vet kryetari i Komunës së Dibrës, z Argëtim Fida, është i angazhuar në tërheqjen e sa më shumë bizneseve nga di-

jen e ambientit. Kjo pronë pra kazerma ushtarake, siç e thërrasin në Dibër të Madhe, do të ndahet në disa parcela, sipas kërkesave dhe planit që do të nxjerr komuna. Dhe meqëse aty kemi të bëjmë me një sipërfaqe të konsiderueshme dhe shumë afër qendrave të banuara, do të planifikojmë që të ndërtojmë një degë të Universitetit të Tetovës, aty në atë zonë.

**A ka konflikt interesi në administratën tuaj?**

Jo dhe ndoshta jemi Komuna e vetme në rang republikan - që s'kemi asnjë rastë të këtill deri tani; Konflikti i interesit dhe korrupsioni e mitmarra në administratën e Komunës së Dibrës së Madhe pothuajse është zero. Komuna i ka hapur luftë këtyre fenomeneve qysh në ditët e para - prej se kur ërdhëm në pushet. Pasi këto dukuri para se të vinim ne - ishin të dukshme në Komunën e Dibrës së Madhe. Përveçse kjo luftohet me ligj, ligji i cili nuk i lejon as kërkujt të punojnë në administratë në se dikush nga punonjësit e saj ka konflikte interesi, por edhe vetë administrata nuk lejon penetrimin sado të vogël të këtyre interesave në administratë. Sikurse edhe korrupsioni, kriminaliteti, droga dhe prostitucioni në qytetin tonë nuk egzistojnë fare, pasi ato luftohen duke i bërë luftë të hapur që në nisje. Dhe vetë biznesmenët, afaristët dibranë, qytetarët e saj kurrësesi nuk janë të prirur dhe i kan luftuar me të gjitha mënyrat fenomene të tilla. Të gjithë janë shumë transparent, serioz dhe në përputhje me ligjin në aktivitetin e tyre pra nuk kemi ndonjë rastë të këtill. Dhe as që mendojmë që ka për të pasur në Dibër të Madhe fenomene të tilla shqetësuse.

**Si bëhet komunikimi i drejtpërdrejt qytetar - komunë?**

Përveçse, raporteve faktike të cilat bëhen publike, sipas programeve e raporteve tremujore gjashtë dhe një vjetore, të të hyrave dhe të dalave të Komunës, ne për herë të parë po aplikojmë edhe një praktikë perendimore të administrimit komunal, që vetëm komunat e bashkitë në vendet më të zhvilluara të botës e kanë deri tani. Në Komunën tonë ka çdo të martë takimim dhe debatë me qytetarët dibranë në sallën e komunës. Sakaq, zyrat e Komunës, sipas dikasterit kan dy orë në ditë komunikim me qytetarët prej nga ora 10 deri 12 të çdo dite të javës nga e hëna deri të premtën,

**Mesazhi i juaj për dibranët!**

Është momenti më i favorshëm dhe një shancë që nuk duhet humbur për afaristët dhe biznesment dibranë në Amerikë, që të vijnë e të investojnë tash në Dibër të Madhe. Ne jemi duke përgatitur planin për rregullimin e e Bregut të Liqenit, e cila, parasheh ngritjen e një kompleksi multi funksional dhe modern për tërheqjen më pasë të turizmit të virgjër në këtë zonë, dhe më pas hapjen e rrugës së Arbërit, e cila parashikon t'i jap shumë prioritet Dibrës së Madhe për zhvillim - do të çelim variacione të reja biznesi. Ne kemi ligje dhe disponojmë kushte për të krijuar lehtësira çdo dibrani, që t'i mundësojmë atyre biznes të suksesshëm. Prandaj u bëjë htirje të mos hezitoni më, por e jani të investoni dhe shihni vetë se çfarë ndryshimesh po bëhen në Dibër të Madhe, çdo ditë. Dibra e Madhe është një ndër komunat në nivel republikan që ka shumë favore natyrale për zhvillim - Dibra e Madhe po ndryshon çdo ditë.

Nga: Rexhep TORTE

Në takimin e FBKSH-Frontit për Bashkim Kombëtar Shqiptar në Durrës në dhjetor të vitit 2009, ku merrnin pjesë përfaqësues të FBKSH-së nga mbarë trojet shqiptare dhe nga diaspora, Gafur Adili-kreu i FBKSH-së, në fund të këtij takimi u tha të pranishëmve, "së shpejti në mesin tonë do ta kemi edhe Mr. Ukshin Hotin".

Ky lajm i gëzueshëm përmes kanaleve të sigurta u përhap rufeshëm nëpër trojet shqiptare dhe në diasporë. Ky lajm është një ugur i mirë në favor të sedit dhe të dinjitetit të atyre që kur nuk shkelin mbi bëmat dhe sakrificat e bijëve tanë që gjithnjë kanë punuar për çështjen kombëtare shqiptare. Ky lajm ka peshën e vet kur bëhet fjalë për Mr. Ukshin Hotin për fatin e të cilit u krijuan lloj lloj mjegullinash të veshura me indiferentizmin e klasës qeverisëse dhe politike kosovare, që çështjen e Mr. Ukshin Hotit e kanë lënë në hareshë.

Me potencialin e tij të pakrahueshëm të njohjes së rrethanave të diplomacisë ndërkombëtare, të situatës politike të djeshme e të sotme, të përvojës së tij të çmuar, të njohjes nga ana e tij të tri gjuhëve botërore, të aftësisë së tij konsekuente e vizionare në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme në kohë e situata përkatëse, por edhe për shkak të personalitetit të dëshmuar, syptrembur, i palëkundur, Mr. Ukshin Hoti do të ishte shumë i dobishëm për Kosovën gjatë negociatave për pavarësinë dhe pas shpalljes së pavarësisë.

## SI E NJOHA MR. UKSHIN HOTIN

Kam shumë shokë e shoqe nga vise të ndryshme të Kosovës. Kjo erdhi si rezultat që gjatë studimeve në Beograd isha kryetar i Shoqatës Letrare-Muzikore "Përpjekja"-shoqatë e studentëve shqiptarë në Beograd, e cila me aktivitetet e saj letrare dhe muzikore la gjurmë të pashlyera të një organizimi studentor me përmasa lakmuese kulturore dhe atdhetare.

Në Beograd u njoftova edhe me Mr. Ukshin Hotin, asokohe kuadër i Kosovës dhe shef i departamentit për marrëdhënie me jashtë në LSPJ-në e atëhershme. Unë organizoja jetën kulturore të studentëve dhe të punëtorëve shqiptarë që jetonin dhe punonin në Beograd, ndërsa Ukshin Hoti ishte caktuar që në tribunat e organizuara, punëtorëve shqiptarë tua spjegojë domethënien e amendamenteve kushtetuese që pritej të aplikoheshin në ndryshimet e Kushtetutës së Jugosllavisë së atëhershme në vitin 1974.

Ai në këto tribuna thoshte, citoj: "Derisa Kosova nuk e gëzon statusin e merituar, do jetë thikë në shpinë të Serbisë".

Pata rastin të shikoj me admirim etjen e Ukshinit për të lexuar dhe për të ngritur shkencërisht. Disa herë u orvat që temën e magjistraturës ta merrte për gjendjen e shqiptarëve në Ballkan, por për këtë temë nuk gjeti



Foto e Ukshin Hotit e viteve të 1970

# Vit shprese për gjetjen e Mr. Ukshin Hotit

asnjë mentor të përshtatshëm. Në fund Prof. Pribiçević, ligjërues në Fakultetin e shkencave politike në Beograd ia pranoi temën e magjistraturës me titull "Faktori kinez në marrëdhëniet Rusi-Amerikë, të cilën e mbrojti në mënyrë brilante. Asokohe ai shkoi për një vizitë tremuajshe edhe në Angolë, si mysafir i liderit të atjeshëm Agostino Neto, i cili ishte në krye të lëvizjes revolucionare "Frelimo".

Unë pata rastin të shkoj në fshatin e tij të lindjes në Krushë të Madhe dhe ai sëbashku me Edin dhe vllaun e tij Ragipin erdhën disa herë në Dibër, dhe ai shumë herë qe mysafir në shtëpinë tonë në Dibër.

Mr. Ukshin Hoti preferonte jetën normale e modeste larg çdo ekstravagance. Nuk e dëgjova asnjëherë që të flet për veshje luksoze, vetura luksoze, apo për ndërtimin e ndonjë vile banimi. Opsionin e tij ishte blerja e librave, ndërsa tema e bisedës ishte Kosova dhe çështja e pazgjidhur shqiptare. Mr. Ukshin Hoti u revoltua shumë nga padrejtësia që mu bë mua në dhjetor të vitit 1971 në Dibër, kur qarqet moniste përdorën deklaratat plot insinuata të Njazi Limanovskit dhe Halit Bashës për të më burgosur dhe larguar si gazetar të "Rilindjes" nga Dibra. Mr. Ukshin Hoti më ndihmoi shumë me sugjerimet e tij në shkresat që ua dërgova institucioneve të atëhershme për të dëshmuar pafajësinë time dhe padrejtësinë që mu bë. Mr. Ukshin Hoti u gëzua pa masë kur pas shumë vite peripecishë më në fund u pranua në konkursin e shpallur si përkthyes në Këshillin Ekzekutiv Federativ. Gjatë një darke në vitin 1981 në Beograd, ku ai për herë të

fundit kishte ardhur si i dërguar i Kosovës në një takim pune, me keqardhje shprehej për qëndrimin negativ që kishin patur disa profesorë për demonstratat studentore të vitin 1981 në Prishtinë, dhe për kritikën konstruktive që ai ua kishte bërë atyre për oportunitetin e treguar në mbledhjen aktivitet politik. Me që unë tashmë isha përballur me regjimin e egër policor dhe shtetëror, e këshillova që në kësi raste të silltet më me maturi dhe tu ruhet provokimeve. Pas kësaj nuk kaloi as një muaj, kur gjatë një telefonate timen në banesën e tij në Prishtinë, bashkëshortja e tij Edi Shukriu më dha lajmin se Ukshinin e kishin arrestuar.

## TËRË FAMILJA VIKTIMË PËR KOSOVËN

Mr. Ukshin Hoti është lindur në vitin 1943 në Krushë të Madhe. Babai i tij Nazifi vdiq në vitin 1999 si pasojë e plagëve të mara nga bombardimi serb ndaj shtëpisë së tyre, ndërsa nëna Fatime ndërroi jetë në verën e vitit 2004 e vuajtur dhe e traumatizuar. Ragipi, vllau i Ukshinit ra dëshmor si luftëtar i UÇK-së. Nga familja e ngushtë kanë mbetur motrat Myrvetja, Resmija dhe Afrimi, vëllai më i vogël. Mr. Ukshin Hoti shkollën normale e kreu në Prizren dhe Prishtinë, studimet në Fakultetin e shkencave politike në Zagreb, studimet pasuniversitare në Beograd dhe një vit specializimi në universitetet amerikane në Çikago, Harvard, Kembrixh, Boston dhe Uashington, ku njihet me personalitete të shquara të shkencave poli-

tike si Jeremy Israel, Steven Jarabee, Hans Montenegro etj. I propozuar nga zonja Rosalyn Carter në Uashington DC, zgjidhet si përfaqësues i të gjithë studentëve pasuniversitarë nga Evropa në SHBA. Me të kthyer në vendlindje punon në LSPJ në departamentin për marrëdhënie me jashtë, e pastaj ligjërues në Fakultetin juridik në Prishtinë - dega e jurisprudencës-diplomacisë, ligjërues në Fakultetin filozofik-dega filozofisociologji, ligjërues në shkollën politike të qendrës krahinore, sekretar krahinor në Sekretariatit për marrëdhënie me botën e jashtme dhe anëtar në shumë forume të atëhershme federative që merrshin me politikën ndërkombëtare.

Tatëpjeta e Mr. Ukshin Hotit fillon pas mbledhjes së aktivitet politik në Fakultetin filozofik në Prishtinë më datë 19 nëntor 1981, kur haptas vihet në mbrojtje të demonstratave studentore që kërkonin shpalljen e Kosovës Republikë, me ç'rast arrestohe dhe dënohet 9 vite burg, prej të cilave vuan 3 vjet e gjysëm. Pas daljes nga burgu për tu shmangur nga izolimi shkon në Lubjanë dhe bashkëpunon në revistat "Alternativa", "Republika", ndërsa e drejton vetë revistën "Demokracia Autentike-DEA". Në vitin 1991 pas ndalimit të revistës sërisht kthehet në vendlindje. Në vitin 1993 burgoset sërisht për shkak të pjesëmarrjes në homazhin masiv për martirët e demokracisë në Brestovc, dhe po këtë vit duke u kthyer nga një vizitë e organizuar te grevstët e urisë në Pallatin e shtypit në Prishtinë, kapet dhe rahet mizorisht nga policia speciale

serbe. Të gjitha këto nuk e mposhtin shpirtin atdhetar të Mr. Ukshin Hoti. Ai vazhdon aktivitetin e tij duke marrë pjesë edhe në tubimet gjithkombëtare në Shkup dhe Tetovë dhe vihet në krye të partisë UNIKOMBI. Për t'ia ndërpre rrugën e përpjekjeve për pavarësinë e Kosovës regjimi serb sërisht e burgosën më 17 maj 1994 dhe me akuzat të paqarta e dënoi edhe me 5 vite burg. Në pyetjen e bërë gjyqtarës serbe si mund ta dënoni një njeri të pafajshëm, ajo është përgjigjur, "Ukshin Hoti, megjithatë, nuk është i marrë sa të kuptojë se ia kam shqiptuar unë dënimin". Mbrojtja e Mr. Ukshin Hotit para kësaj gjykate u konsiderua si manifest dhe përgjigje politike e humane në sqarimin e problemeve politike serbe e shqiptare për gjetjen e zgjidhjes së drejtë që këto dy popuj do ti shpëtonte nga konfrontimet, gjë që edhe u vërtetua me agresionin serb ndaj Kosovës në vitin 1998/99 dhe me pasojat shkatërrimtare të tij ndaj shqiptarëve.

## SAKRIFIKUES PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Mr. Ukshin Hoti është liruar nga burgu i Kosovës një ditë më heret, më 16 maj 1999, ditën e diel, edhe pse e diela nuk është ditë pune.

Mr. Ukshin Hoti e kanë parë duke dalur nga burgu me një strajcë krahëve, të shoqëruar nga tre punonjës të sigurimit serb, dhe pastaj i humbet çdo gjurmë.

Myrvete Kasumi, motra e Ukshin Hotit, thotë se, "vetë fakti që Ukshini është transferuar nga burgu i Prizrenit në burgun e Dubravës, nga burgu i Dubravës në burgun e Nishit, nga burgu i Nishit në burgun e Mitrovicës, do të thotë shumë. Ukshinin nuk e kanë lënë në asnjë mënyrë të ambientohet në rrethin që krijonte me shokët e vet të burgut, e kjo për njeriun do të thotë shumë nga aspekti i torturës psikike". Më kujtohen shumë situata tronditëse nëpër burgjet ku gjendeshte. Në burgun e Nishit ia pashë duart e pezmatuara e të bëra varë nga gishtërinjtë e përpjetë, sepse pastronte nevojtoret dhe korridoret e burgut. Ukshini më tregonte se shpesh e mbyllnin nëpër qelitë e izolimit.

Përveç individëve të caktuar të cilët kanë lidhshmëri shpirtërore dhe shoqërore me Ukshin Hotin, që kohëpaskohe dalim me ndonjë shkrim për personalitetin e tij nëpër gazeta, tjetër gjë në nivel të partive politike apo të qeverisë nuk ka.

Mr. Ukshin Hoti mbetet shembull i pamohueshëm i angazhimit të flaktë dhe i sakrificës së sinqertë për Pavarësinë e Kosovës. Tani është nevoja që ata të cilët e njohin kauzën e tij të ngrenë zërin dhe ta sensibilizojnë maksimalisht zbardhjen e fatit dhe të vetëqëndrimit të tij. Lajmi që doli nga goja e Gafur Adilit në takimin e FBKSH-së në Durrës duhet të merrtet seriozisht dhe të materializohet në favor të Mr. Ukshin Hotit, patriotit, intelektualit, diplomatit dhe njeriut të penës e të pushkës për prosperitetin mbarëshqiptar.



merri kopjen tënde

Bëhuni pjesë e gazetës!

E-mail: [rrugearberit@gmail.com](mailto:rrugearberit@gmail.com).  
Tel. (04) 22 33 283 / 068 31 19 232  
[www.dibra.org](http://www.dibra.org)



Nga: **MOISI MURRA**

Qyteti i Peshkopisë gjendet në koordinatat gjeografike: gjatësi lindore 20°25'25" dhe gjatësi veriore 41°40'56". Ngrihet në një terren malor të gjelbëruar të Shqipërisë verilindore, në lartësinë mbi detare 656m. Kur në Evropën Qendrore ora është 12, 00, ora lokale në Peshkopi shënon 12.00 21' 43". Rajoni i Dibrës është i banuar që në mijëvjeçarin e VI p.e.s. Në antikitet treva e sotme e Dibrës njihet me emrin **Penestiana Terra** (Toka e Penestëve). Në të gjithë këtë territor autorët antik, Polibi dhe Tit Livi, përmendin 14 qyteza dhe tri kështjella, prej të cilave, tri na japin me emër : Uskana (Uscana), Oenea (Oaeneum), Draudak (Draudacum).<sup>1)</sup> Dy të parat përmendën si qyteza, ndërsa Draudaku dhe 10 pika të tjera si kështjella. Luftrat iliro-romake dhe makedonase-romake, që u zhvilluan në truallin e Penestëve, në vitet 172-168 p.e.s dëmtuan rëndë fisin ilir të penestëve, aq sa pas vitit 168 p.e.s emri i tyre humbi përgjithmonë. <sup>2)</sup> Tre shekuj me vonë, shek. II i.e.s, del në skenë një qytet me emrin Doberos, të cilën gjeografi Aleksandrin, Klaud Ptolemeu e vendos në koordinatat gjeografike 46° 41' gjatësi dhe 40° 45' gjerësi.<sup>3)</sup> Sipas këtyre koordinatave, Dibra ndodhet në verilindje të Skampinit (Ebasanit) dhe në veriperëndim të Luhnidit (Ohrit). Në vitin 1019, nga ana fetare, Dibra hynte në Arqipeshkopatën e Ohrit.<sup>4)</sup> Një vit më vonë, 1020, Dibra ka epishkopinë e saj, me qendër në Peshkopi, saktësisht në mëhallën Bulke të Dobrovës.

Në vitin 1040 Dibra përmendet si krahinë. Ndërsa në vitin 1257 shkruantari bizantin Akropoliti është i pari që përmend Dibrën në shumës: Dibrat.<sup>5)</sup> Albanologu gjerman I.G.Han shkruan se emri Diber, në gjuhën bullgare, do të thotë grykë.<sup>6)</sup> Në defterin turk të vitit 1467 vilajeti i Dibrës jepet me 188 fshatra, 75000 banorë. Në fund të shek. XVIII Dibra numëronte 25000 banor me 220 katunde. Sot Dibra ka 96190 banor nga të cilët 72253 ose 80% jetojnë në fshat, 19937 ose 20% jetojnë në qytet. Qyteti i Peshkopisë, që në shek. XI, në hartat bullgare, shënohet me emërin "Presolengrad", x) që do të thotë Kryevend. Gjetjet arkeologjike, në qendër të qytetit të sotëm dhe në periferi, dëshmojnë për një jetë qytetare ilire, që datohet shek. III-II p.e.s.y) Aty nga mesi i viteve 527-560 perandori Justinian, për të mbrojtur Perandorinë Lindjes nga fiset barbare, ngrihet një sistem kështjellash vigane ushtarake nga Tuna në Helladë.<sup>7)</sup> Një kala ilire, me përmasa 1.5 ha (250 m në lind-



Qyteti i Peshkopisë, më 1920

## Qyteti i Peshkopisë nga lashtësia në ditët tona



Qyteti i Peshkopisë, korrik 2009

je-perëndim dhe 600 m veri-jug) <sup>8)</sup> ngrihet dhe në kodrën, që gjendet në perëndim të fshatit Begjunec, në jugë të llixhave të Peshkopisë dhe në veri të fushës së Dobrovës. Me që gjuha zyrtare në Perandorinë e Lindjes ishte greqishtja, historikruesi i perandorit Justinian, Prokopi i Çezares, e ka përkthyer kalanë-qytezë ilire, që nga vendasit quhej KUNOR, në Stefaniakos. (Konor = Stefaniak). Pozita dominuese e kësaj kodre, 698 m mbi nivelin e detit, si dhe prania e rrugëve të degës Egnatia, që lidhnin pellgun e Peshkopisë me pellgun e Prizrenit

në veri dhe me pellgun e Gostivarit në lindje i jepnin kalasë një rëndësi të veçantë gjeostrategjike. Në vitin 1020 Dibra fiton statusin e një qendre episkopale, që në burimet bizantine njihet me emrin "Episkopata e Stefaniakës." <sup>9)</sup> Dhe po këtë vit nis dhe përfundon ndërtimi i saj.

Duke pranuar lokalizimin e Stefaniakës në Gradishten e sotme të Peshkopisë, domosdoshmërisht zgjasim duart në onomastikën dhe toponimin historike, në lidhje me emrin "Shqefën" dhe "Peshkopi". Emri Shqefën, patronim, që sot e


mban një fis i lagjes Bulke përreth Stefaniakës së dikurshme, është një transformim nga emri antik Stefaniak në Shqefën. Përputhja fonetike dhe territoriale e këtyre dy emrave topik (Stefaniak dhe Shqefën) është bindës. Më vonë katedra episkopale e Dibrës ndërroi seli edhe dy herë të tjera, por i la emër qytetit të sotëm të Peshkopisë. "Një kështjell i ri, -ka shruar kroati Milan Shuflai, me emrin grek është Stefaniakon, nga i cili merr emrin e vet Peshkopia shqiptare e mëvonshme."<sup>10)</sup> Edhe emri i qytetit është një transformim fonetik i em-

rit peshkopatë të Stefaniakës (Shqefnit) në Peshkopi. Edhe në këtë rast kemi përputhje fonetike me atë territoriale. Me fjalë të tjera të tjera emri i sotëm i qytetit të Peshkopisë vjen nga emri i Peshkopatës së Dibrës, që u ngrit në vitin 1020 në lagjen Bulke të Dobrovës. Prandaj dhe për këtë vit 1020 duhet të konsiderohet viti i themelimit të qytetit të Peshkopisë. Kjo kala, që nga autorët antik u përkthye nga Kunorë, në Stefaniak, nga serbët e Stefan Dushanit u quajt Gradishtë, emër i cili nuk është ndryshuar dhe sot e kësaj dite. Në vitin 1467 kisha e Stefaniakës (Shqefnit) ruante po ato konture si në vitin 1020 kur edhe u ndërta. Në këtë kohë, 1467, qyteti i Peshkopisë numëronte 32 shtëpi me 224 banor.<sup>11)</sup> Në vitin 1863 kishte 2100 banor, në 1891 pati një rënje prej 155 banorëve, në 1938 përsëri ka rënje, qyteti numëronte 1414 banor, në vitin 1960 numri i banorëve ishte rritur në 5041, në vitin 1990 arriti në 12.300 banor dhe në janar të 2009 qyteti i peshkopisë arriti në 19.937 banor.<sup>12)</sup> Në këta dy dhjetëvjeçarët e fundit dhe pse lëvizjet e lira të banorëve kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shpeshta, ata nuk kanë ndikuar në prishjen e ekuilibrit demografik. Pavarësisht prurjeve dhe largimeve nga qyteti, fiset autoktone: Shqefni, Shehu, Limku, Stojku, Zenuni, Kaleci, Kuçka (Hoxhaj), Kallaverja, Vraniçi, Bulku, përbëjnë shumicën kompakte të zhvillimeve demografike të qytetit. Në qytetin e Peshkopisë bashkëjetojnë tre konfesionet fetare: musliman, katolik dhe ortodoks. Dy të fundit gjenden në një përqindje shumë të vogël. Qyteti rezultoi të islamizuar tërësisht, që në vitin 1583.<sup>13)</sup> Në vitin 1864 turqit osman e bënë Peshkopinë qendër të Kazasë së Dibrës së Poshtme.<sup>14)</sup> Pas 6 vjetësh, 1873, në Peshkopi qe ngritur një kazerme dy katëshe, që strehonte deri në 8000 ushtarë. Qenë ngritur dyqane në anën e djathtë të përroit të Bellovës dhe ishte vendosur linja telefonike Pshkopi – Oranik (Shehri i Dibrës).<sup>15)</sup> Në vitet 80 të shek. XIX. Në qyteti i Peshkopisë numëroheshin 15 dyqane, 3 hane, 20 mullinj, ku kryenin tregti 38 fshatra. Në vitin 1913 rrjeti tregtar në Peshkopi ishte rritur në 26 dyqane, disa hane e mejhane. Në qytet ushtronin veprimtaritë Zanatçinjë, kalljxhi, teneqepunues, opingar, orëndreqës, furrxhi, etj 'x) që i kishin dyqanet në dy anët e sheshit të sotëm Bajram Curri. Me ndonjë ndryshim të vogël ky rrjet tregtar do të vazhdonte deri në vitin 1946, kur nisen shtetëzimet e para të elementëve kapitalist. Nga viti 1946 dhe deri në 1990 në qytetin e Peshkopisë u ngritën 15 ndërmarrje shtetërore si : Ndërmarrja Tregtare, Komuna e Banesa, Ndërtimi, Grumbullimi, Prodhimet e Ndryshme, Parku Automobilsik i Mallrave, Ushqimorja, Ndërmarrje Bujqësore, Rruga Ura, Postë Telegraf-Telekomi, Mermeri, Stacioni i Makinave dhe Traktorëve, Pyjorja, Ujrat, Uzina Mekanike. Sot në qytetin e Peshkopisë ushtrojnë bizneset e tyre 588 njësi si: bar-kafe + restaurant 118, ushqimore 40, fruta perime 40, industrial 114, dyqane mishi 12, karburante 2, byrektore 15, furra buke 5, artizanat 76, hoteleri 8, farmaci 7, klinika dentare 8, tregti ambulante 100, biznes i madh 38 etj,

Në 17 gusht të vitin 1920 në qytetin e Peshkopisë u ngritën administratat e para vendore në rang prefekturë me prefekt Ramiz bej Dibrën'y) dhe po atë ditë ngrihet edhe komuna, që u konsiderua bashki, me kryetar Shehat Shehun.<sup>16)</sup> Më 17 korrik



Gradishtë e Peshkopisë



Episkopata e Stefaniaka, Shqefnit e vitit 10





Nga: ARBANA QORMEMETI \*

Qyteti i Dibrës ndodhet në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë, 125 km larg qytetit të Shkupit. Në pjesën veriore kufizohet me komunën e Rostushës, në pjesën verilindore me komunën e Qendrës së Zhupës, një pjesë e vogël e territorit kufizohet me komunën e Llukovës (Strugës) në pjesën jugore, ndërsa në perëndim me vijën kufitare me Republikën e Shqipërisë. Liqeni i Dibrës, lugina ku gërshetohen lumenjtë Radika dhe Drini i Zi, ka një gjatësi prej 35 km dhe gjerësi maksimale prej 2.5 km. Të dyja këto anë të lumit janë të përmendura prër bukuritë e tyre natyrore të paprekura, e një pjesë e tyre i takojnë parkut nacional. Qyteti i Dibrës është i rrethuar me malet e Deshatit, Kërçinit dhe Stogovës. Në Komunën e Dibrës jetojnë rreth 17 000 banorë, më një strukturë nacionale: 65% e popullsisë janë shqiptarë, 18,8% maqedonas, 11% turq dhe 6,3% rom.

### Dibra në të kaluarën

Të dhënat e para për ekzistimin e qytetit të Dibrës shënohen qysh në shekullin e V.p.e.s. nga Strabonius dhe Plini. Më vonë në shekullin e II përmendet nga astronomi dhe kartografi grek Ptolemei, në shënimet e tij për ekzistencën e qytetit Dober. Pas periudhës së Ilirëve, Dibra ka qenë e pushtuar nga Car Samolli, më vonë nga cari Bullgar Vasili i shekullit II. Në shekullin e XV pasi Skënderbeu kthehet nga Stambolli ai vendoset në kështjellën e Svetigradit, që është 5 km larg nga qyteti i Dibrës dhe përafërsisht 15 km, nga vendlindja e tij Kastriot. Një pjesë e madhe të ushtrisë Skënderbeu e rekrutoi nga krahina e Dibrës, Pas vdekjes së tij Dibra u pushtua nga Imperia Otomane. Në këtë kohë në Dibrë filloi të zhvillohet tregtia, zëjtaria, bujqësia, dhe zanatet e tjera, u themeluan shkolla të përmendura për përpunimin e gurit dhe të drurit. Në këtë periudhë në Dibrë, u krijuan



Foto: Argjent R. Kaba

# Dibra, djepi i diturisë

shumë familje të pasura bejlerësh, agallarësh e tregtarësh, pasuria e të cilëve shtrihej jo vetëm në rrethin e qytetit por edhe më gjerë. Një fjalë e vjetër popullore thotë "Edhe nëse Stambolli digjet Dibra do ta rindërton", e cila na përshkruan potencialin ekonomik të Dibrës në atë periudhë kohore. Pas mbarimit të luftës së parë Ballkanike 1912-1913 Dibra ra në duart e Shqipërisë, por pastaj iu dherua mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe sllovenëve si shpërblim nga aleatët fitues të luftës për kontributin e tyre në Luftën e parë Botërore. Në periudhën e pasluftës së dytë botërore Dibra shënon rënie më të madhe ekonomike të saj. Dy faktorët që ndikuan në këtë rënie ekonomike janë në radhë të parë politika joadekuante shtetërore ndaj popullsisë lokale.

### Faktorët kryesor për rënien ekonomike në Dibrë

Në vitin 1967 Në Dibrë u ndërta hidrocentrali elektrik "Spile". Me ndërtimin e këtij hidrocentrali u përmbyt toka më pjellore e komunës së Dibrës, lugina e Udovës, bujqit për tokën e përmbytur u kompensuan nga shteti me shuma simbolike parash. HEC "Spile" me një prodhim mesatar ditor prej 1.000.000 ne ditë deri më sot nuk ka kontribuar aspak në përmirësimin e ekonomisë së qytetit, poashtu "Spile" si koncesioner

i liqenit nuk shfaq interes në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aktivitetëve në liqen. Shpresojmë që në të ardhmen, me ndikimin e pushtetit lokal, ky subjekt do të angazhohet më shumë në këtë drejtim. Me përmbytjen e rrugës së vjetër që lidhte Dibrën me Gostivarin në veri, dhe me Strugën në jug u ndërtua rruga e re që shtrihej mbi nivelin e liqenit. Dibranët edhe sot e kësaj dite nuk e kanë të qartë se si u ndërtua plani i kësaj rruge nga 7 metra që ishte planifikuar në 5 metra gjerësi. Sot gjerësia e rrugës përbën një hendik për madh të mirëfilltë ekonomik të rajonit. Si faktor i dytë ekonomik për rënien ekonomike të Dibrës është ndarja e rrethit të Dibrës në dy pjesë. Pas Luftës së dytë Botërore qyteti i Dibrës i takoi ish Jugosllavisë ndërsa pjesa më e madhe e rrethit të saj i takoi Shqipërisë. Me mbylljen e kufirit u bë e pamundur shkëmbimi i mallrave dhe të mirave në rajon. Ekonomia e qytetit të Dibrës tradicionalisht ishte lidhur ngushtë me Tiranën dhe Durrësin

Dibra në territorin e Maqedonisë nuk ka ndonjë qendër banimi më të madhe. Nga ana tjetër në Shqipëri, Prefektura e Peshkopisë dhe rrethet e saj kanë rreth 180 000 banorë. Tani pas dyzet vitesh, ky numër i madh i popullsisë përbën një potencial ekonomik dhe tregtar në Komunën e Dibrës që duhet shfrytëzuar edhe më shumë në të ardhmen. Tregtarët dib-

ran janë duke e ndërjer rritjen e fuqisë blerëse të kësaj popullate, sidomos gjatë ditëve të tregut në Dibrë ku vërehet qartë pasi një pjesë e madhe e blerësve janë nga Shqipëria. Në të ardhmen kjo tendencë pritet të rritet edhe më shumë.

### Mundësitë reale për një Dibrë me perspektivë

Komuna e Dibrës ka përkrahur dhe do të ndihmojë çdo iniciativë dhe fushën e biznesit që shpije në hapjen e aktivitetëve dhe krijimin e vendeve të reja të punës duke marrë parasysh papunësinë madhe, mbi 4 700 dibranë. Kjo do të vërehet edhe më shumë në të ardhmen ku me procesin e decentralizimit deri më sot Komuna e Dibrës ka pasur bashkëpunim të frytshëm me organizatat ndërkombëtare dhe të vendit që funksionojnë në Republikën e Maqedonisë. Donacionet e ndryshme si UNDP, USAID, Banka Botërore, IOM, NORWAK, kanë realizuar projekte të shumta për zhvillimin ekonomik të Dibrës.

Rajoni i Dibrës ka traditë në rritjen e dhenve, si rezultat i kësaj ky rajon është i njohur për prodhimin e djathit të bardhë të dhenve, dhe viteve të fundit po bëhet përpjekje për standardizimin e prodhimit të këtij djathi, e kjo do të jetë garant për standardizimin e prodhimit të këtij djathi të njohur në tregje të reja. Para disa vitesh fabrika Knauf morri ini-

**Dibra qysh në të kaluarën njihet si djepi i diturisë në këto hapësira. Një ndër zakonet më të rëndësishme të Dibrës është shkalla më e lartë e arsimimit. Qysh në fillimin e shekullit të kaluar shumë dibranë të rinj janë shkolluar në Universitet e Bolonjës, Europë dhe Normalen e Elbasanit.**

ciativën për ndërtimin e terminalit doganor në Dibrë dhe pritet që së shpejti të realizohet. Në këtë terminal të ardhshëm do të doganohet malli që do të importohet nga Shqipëria dhe vende të tjera, do të transportohen në Kosovë, Bullgari, Kroaci dhe Bosnjë dhe numri i më shumë se 30 kamionëve në ditë është një garant për rentabilitetin e këtij terminali. Përfshirja e tregut të liqenit në planin urbanistik të qytetit jep mundësi për ndërtimin e objekteve rekreative buzë liqenit të Dibrës dhe zhvillimit të sportit ujor

### Dibranët me arsim më të lartë në Maqedoni

Dibra qysh në të kaluarën njihet si djepi i diturisë në këto hapësira. Një ndër zakonet më të rëndësishme të Dibrës është shkalla më e lartë e arsimimit. Qysh në fillimin e shekullit të kaluar shumë dibranë të rinj janë shkolluar në Universitet e Bolonjës, Europë dhe Normalen e Elbasanit. Kjo vërehet qartë edhe nëpër Universitet e Maqedonisë, në Universitetin e Tetovës, në Universitetin e Europës Juglindore, në universitetin e "Shën Kirili dhe Metodij", pjesa dërmuese e ligjëruesve, profesorë, doktorë janë dibranë. Të përmendim këtu vetëm prej disave që kanë dhënë kontributin e tyre për Dibrën dhe në mburremi me këta personalitete të shquara si, Haki Stërmilli, Said Najdeni, Gëzime Shehu-Starova, Mahmut Hysa, Stereo Spase etj.

\* Arbana Qormemeti është profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë maqedonase në shkollën e mesme "ZRAVKO COCKOVSKI"-DIBER.

## Qyteti i Peshkopisë nga lashtësia në ditët tona

► 2010 dibranët e kanë të ligjshme të kremtojnë 90 vjetorin e ngritjes të pushtetit vendor, prefekturës dhe bashkisë së Peshkopisë. Edhe pse u ngrit administrata vendore në qytetin e Peshkopisë, në korrik të 1920, Dibra, si trevë, vazhonte të ishte nën pushtimin serb, që në nëntor të 1912, kur ushtritë serbe mësynë viset verilindore të Shqipërisë. Ushtri të tjera austrohungareze (qershor 1916), bullgare 00 (1 janar 1916) pushtuan Dibrën. Gjatë Luftës së II Botërore si gjithë Shqipëria dhe Dibra u pushtua nga nazifashistët, pushtim i cili, si dhe ai serb i viteve 1912-1921, nuk kaloi pa pasoja. Nga viti 1920 dhe deri në korrik 1944 qyteti i Peshkopisë ka qenë bashki, pastaj Këshill Nacionalçlirimtar, lokalitet, këshill pluralist dhe së fundit përsëri bashki.


Qyteti i Peshkopisë është qytet piktoresk. Është i veshur me drurë të kultivuar dekorativ si: bli, pisha e zezë, bredh, mëshktekna, gështenja e egër, ceder, liguistër, panje fletëfashër, gledice etj. Blirët në të dy anët e "Shtetitores Elez Isufi" i kanë dhënë qytetit të Peshkopisë emërin "Qyteti i Blirëve". Qyteti përbëhet nga 6 lagje: "Nazmi Rushiti", "Gjok Doçi", "Ve-hbi Dibra", "Seit Naideni", "Aksioni" dhe lagjia e "Llixhave". Në qytet e janë të instaluar dhe vepronë: Prefektura, Keshilli i Qarkut, Bashkia, Gjykata dhe Prokuroria, Arkivi Vendor i Shtetit, Drejtoria Arsimore, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Drejtoria e Policisë së Qarkut, Drejtoria e Punës, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Drejtoria e Shërbimit Social Shtetror, Drejtoria e

Shërbimit Parësor, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e thesarit, Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Telekomit dhe Posta, Drejtoria e Kulturës, Filali i Universitetit "Aleksandër Moisiu" i Durrës, Shkolla e Mesme e Përgjithshme, e Mesmja Profesionale, kater shkolla 9 vjecare, Spitali, si dhe organizatat jo fitimprurëse si: SNV(Netherlands Development organisation), Kryqi i kuq amerikan (KKA), Organizata e zhvillimeve lokale nëpërmjet demokratizimit dhe krijimit të vendeve të punës, Zyra e informacionit të OSBE, Asistencë për fermerët, Ferd Paris (ADAD). Në qytet ushtrojnë veprimtari bankare njëjta Raifaisen Bank, Banka Popullore, Banka Kombëtare Tregtare, Fondacioni Besa, etj. Nga viti 1920, kur u ngrit administrata e

parë vendore shqiptare dhe deri më sot qyteti i Peshkopisë ka luajtur një rol të rëndësishëm si qendër administrative, arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, industriale e rrethit të Dibrës.

REFERENCAT  
1. Ilirët dhe Iliria, Tiranë, 1965, f. 123-124.  
2. K. Frashëri, Studime Historike, nr. 1, 1975, 146.  
3. Ilirët dhe Iliria, Tiranë, 1965, f. 265.  
4. A. Paluca, Gazeta "Tomorri i Vogël", Tiranë, 1nëntor 1942.  
5. K. Frashëri, punim i ciltuar  
6. I. H. Han, Udhtëtim nëpër krahinën e Drinit dhe të Vardarit, Tiranë, f. 189.  
7. Defteri emëror i vilajetit të Dibrës të vitit 1467  
8. Hartat bullgare të shek. XI-XIV  
9. Ilias Kaca, Dibra në faqet e një ditari arkeologjik, f. 43.  
10. Ilirët dhe Iliria, Tiranë, 1965, vol. I, f. 438-439.  
11. Prof. Doktor Adem Bunguri, Gazeta "Rruga e Arbërit", 2006.  
11. K. Frashëri, punim i ciltuar, f. 142.  
12. M. Shullai, Serbët dhe shqiptarët, Tiranë, 1926, f. 7.  
13. Defteri statistikor i vilajetit të Dibrës të vitit 1467, f. 8.  
14. Vjetari statistikor i rrethit të Dibrës, viti 2009.  
15. Defteri i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë të livasë së Ohrit, vitit 1583, f. 499.  
16. po aty.  
17. Jastrebov, Serbia e Vjetër dhe Shqipëria, Beograd, 1904, f. 18/1 e përthimit shqip.  
18. Jovan. Haxhivasilievic, Qyteti i Dibrës në kohën e çlirimit, 1912, Beograd, 1940, 26.  
19. Arkivi i Shtetit Shqiptar, Fondi i Këshillit të Ministrave, viti 1920, dosja nr. 6, dorëshkrim.  
20. Tahir Koçi, kujtime, 13-17, dhjetor, 1976. Kujtimet gjenden në Muzeun e Dibrës.

Shënime në çadër për njerëzit që mes sakrificash vuajtjesh punonin për kërkimet gjeologjike në masivet e Korabit



Nga: Vesel HOXHA\*

(Vijon nga numuri i kaluar)

\*\*\*

Ndërsa kujtoja me mall atë dialog të çmuar që nuk do ta harroi kurrë, dëgjoi zërin e Xhevatit. Ngrihu inxhinier, ngrihu të pimë nga një çaji, çaj të maleve tona. Nata është e gjatë. Me këtë rast bëjmë pak muhabet, harrojmë hallet dhe largojmë mërzinë. Shkëmbejmë mendime. Kështu fitojmë dy palët. Ashtu bëra. Dola nga "dhoma" ku po lexoja e meditoja duke e lodhur mendjen sa andej ketë për punët që më prisnin dhe, ulem pranë Xhevatit në "hollin" e çadrës. Aty kishte vendosur tavolinën dhe karrigët portative. Natën nuk i linim jashtë, i fusim brenda. Era e furnellës me vajguri pas fikjes nuk kishte ikur akoma, ndonëse Xhevatit bënte kujdes dhe e flikte atë jashtë çadme. Dita na vajt mbarë sot, bëme shumë punë - apojo inxhinier - mu drejtua Xhevatit me atë qetësinë e tij të admirueshme, duke hapur bisedën dhe duke më shërbyer filxhanin me çaji mali. Puna ime matet me mineral - iu pergjigja për ta ngacmuar bisedën. Po, po, por pa çadra, pa materiale e pa punëtorë nuk gjendet minerali. Punëtorët që ke menduar të angazhosh për të hapur punimet e kërkimit janë më të mirët - vijoi ai. Pak larg e kanë punën Sherif Ferati me Skënderin Domin, respektivisht nga Kullasi dhe Ujëmira por, jam i detyruar ti angazhoj në këtë punë, edhe pse largimi i tyre nga sondat do ta ketë një çmim. Ato kanë eksperiencë të madhe në hapjen e punimeve të tilla. Kanë dijeni për mineralin që kërkohet pasi, kanë punuar në shumë vende të tilla të ngajshme - vijova pergjigjen unë. Me Sherifin dhe Skënderin isha gati moshatarë, dhe më vinte keq kur i shikoja të punonin në punë që kërkonin lodhje të madhe fizike, sikur të mos u mjaftonte raskapitja në atë malore të pasosur nga Veleshica e deri ne Rrafshin e Korabit, malore që e bënin çdo ditë. Tek i shikoja të vinin të djersitur në vendin e punës, majë maleve, pasi kishin udhëtuar dy orë në këmbë, ku nuk e çoja mendjen. Por ja që.... kësh-tu e ka jeta. Në bisedë e sipër, për të kaluar dhe kohën deri afër gjumit, i drejtohem Xhevatit: Më mirë të kesh mend apo një broke me argjend, ose e thënë ndryshe: Më mirë të kesh dituri apo pasuri. Jo më kot thotë populli, rri në vend e zgjidh mend! Kështu po bëjë dhe unë. Pasi qeshi pak, Xhevatit u pergjigj: Unë kam dëgjuar se të diturit nuk kanë nevojë për pasuri, pasanikët kanë nevojë për dituri. Nuk më ke gjetur gjë Xhevat. Te gjithë të diturit që njohtë unë shumica janë të varfër. E kundërshtova për të parë reagimin dhe për të nxitur të më pergjigjej. Heshti dhe nuk mu pergjigj. Me këtë heshtje e mbyllëm bisedën dhe u shtrimë e fjetëm nën fëshfërimat e lehta të fletës së çadrës italiane, që e lëviste pa pushim era e Rrafshit të Korabit dhe të lehurave të rralla të qenit të baxhos. Nuk do të ishin të pakta rastet kur Xhevat Shehu i Cerenit do të fliste me heshtje, siç më foli dhe atë natë....! Xhevatit ishte më i madh se unë në moshë. Ishte i qetë dhe kishte një mendje të hollë. Mendja dhe duart e tij ishin vazhdimisht në punë. Xhevatit

## Kur kërkonim minerale rrëzë Malit të Korabit

gëzonte respektin e të gjithëve, jo pse e mbaja unë afër, por për ato tipare njerëzore që kishte e mëshironte, që rrezatonte tek të gjithë ne.

\*\*\*

Atë natë nuk më zuri gjumi. I lodhur isha sa s'bën, por gjumi nuk e di pse s'më zuri. Kisha dhe merakun e shpimeve në Sorokol. Mosrealizimi i detyrave do të na përplaste me drejtuesit e Bulqizës. Bluaja në mendje pa pushim si do të më vinte puna e kësaj sipërmarrje kërkuese, që më shumë ishte një nisëativë personale se një detyrë e ngarkuar. Por prap e qetësoja vehtë. Si mundet nga Bulqiza e largët të më mësojnë se ku duhet të përqëndrohem me punime! Vetë i kam shkelur këto anë e i kam parë këto shfaqje, falë dhe shumë njoftimeve popullore. A duheshin verifikuar ato shenja të mineralizuara. Pse s'më sjellin një inxhinier shpimi për të ndjekur ecurinë e son-dave, siç jua kam kërkuar herë pas here, që unë të merrem me punët e mia të drejtpërdrejta!? Kisha kohë që unë thurja lloji - lloji mendimesh e endërrash për perspektivën e mineralizimeve të Izvir-it-Fillim Rrafshit e Rrafshit. Këtu takoheshin disa minerale...dhe kjo situatë kërkonte pergjigje! As sot e kësaj dite nuk ka një pergjigje të plotë, por jam i sigurt se do të ketë. Këtë e them jo nga dëshira por nga ligjësitë e ndërtimit gjeologjik, nga njohuritë e thelluara që kam fituar në punë e sipër ndër vite, për këtë treve interesante mineralmbajtëse. Shpresoj se herët apo vonë ndonjë firmë e huaj do të kryej punime kapitale, do të investoi për ta zhbiruar mineralmbajtjen....! Shumë vite më vonë do të lexoja nga Rexhep Qosja: "Amerikanët kanë një thënie që do të duhej ta dinë edhe ata që s'ë duan romantizmin: "ata që kanë një ëndërr, mund të shpresojnë se do ta sendërojnë ëndërrën, por ata që nuk kanë ëndërr, nuk kanë çfarë të sendërojnë." (226, "Ligjërime paravajtëse", Tiranë 1998).

U ngrita herët, më herët se Xhevatit. Dola mbi një kodrinë të vogël dhe po vështroja gjithçka që kisha rreth e rrotull. Krahëve hodha zgofin e trashë, që ma kishin dhënë në Bulqizë kur punoja ne Dhoks, se bënte shumë ftohtë. Sa herë që punoja maleve shpesh e kujtoja thënien e Artur Shopenhauer: "...shëndeti është një njësh, të cilin mund t'i sh-tosh shumë zero si vlera të tjera, por pa atë, të gjitha mbeten zero." ("Dashuria dhe gruaja"). Kësisoj mundohesha të ruhem edhe nga të ftohtit e mëngjezit të bjeshkëve. Por kujdes i imi për shëndetin në pergjithsi nuk ishte i vazhdueshëm. Në rini shëndeti gënjën shumë njerëz. Kisha marrë në dorë radion me bateri të markës Hungareze dhe, po mundohesha të kap ndonjë stacion me muzikë popullore apo, për të dëgjuar ndonjë lajm. Në atë kohë stacionet e huaja duheshin dëgjuar me "kujdes", aq më tepër se ishim dhe në zonë kufitare. Ndërkohë më tërhiqnin vazhdimisht vëmendjen shtëllungat e reve të zeza tek i shikoja që lëviznin si të tërbuara sa andej ketëj nëpër kreshtat e malit të Korabit. Guzhinieri i ekipit në Ploshtan, Agim Ferati, kur shikonte re të tilla, paralajmëronte prishjen e motit. Tani që çadrën e kisha ngritur dhe kisha vendosur të kryejë punimet sa më shpejt të ishte e mundur, pasi vera ishte e shkurtër, nuk dëshiroja asnjë ditë me shi. Fjala e urtë e Misimit se Moti ndihmon atë që punon, më dukej sikur "do ta pengonte prishjen e motit....!". Kështu i plotësoja dëshirën vehte.

\*\*\*

Me punëtorët u takuam në orën dhe vendin e caktuar. Ramë dakord të ndahen në grupe me nga dy veta. Caktova

katër kanalet e para të kërkimit, rreth 40 m larg njeri tjetrit, në zonat ku kisha dyshimet më të mëdha. Edhe Xhevatit me Misimin do të punonin në kanale. Moshën nuk e kishin për këtë punë të lodhshme fizike. Kishin eksperiencë në hapjen e tyre. Ato e pastronin më së miri zonën minerale. Kjo kishte rëndësi të madhe. Bënin kujdes në detaje për ta kuptuar konturin sipërfaqësor të kanalit. Kërkonin ta piketoja, por ndërkohë në praninë time bënin dhe një konturim me gërvishje të lehtë në sipërfaqe. Kishin frike mos ua lëvizin kunjat, ndaj vijëzimit i jepnin shumë rëndësi. Kishin të drejtë. Edhe ashtu mund të ndodhte. Kishte dhe çobanë apo fshatarë të pa ndërgjegjshëm, që mund ti shkullnin. Nuk vonon shumë



Liqen akullnajor

dhe vjen zjarmëtari Safat Hoxha. Paçim mbarësi dhe rezultat - inxhinier - ishin fjalët e para të tij. Nga gjurmuesit popullore, Safati zinte një vend të rëndësishëm. Shumë shfaqje të Rebive ishin gjetur prej tij. Kishte marrë furnizimin ditor tek depoja fushore afër postës dhe do fillonte të përgatiste materialet për të qenë gati për plasjet. Bënte kujdes që brimat e kanaleve të ishin të thella dhe taposja e mirë, që punë të bënte shumë, e bjeshkën të mos e dëmtonte. Atë merak e kishin të gjithë. Ishin shumë të lidhur me blegtorinë dhe bazën e tyre ushqimore. Ato nuk i dinin konceptet e sotme për mjedisin por, si për bjeshkën dhe për pyjet kishin një rregull të ngurtë. Edhe sot e kësaj dite pyjet mbi Tejas janë të mirëruajtura dhe të mire administruara. Ndahem me punëtorët duke i porositur të bënin kujdes për sigurimin teknik në punë. Pa u larguar as 50 m larg tyre dëgjoi një thirrje. Ishte zëri i Safatit. Më bëri me dije se ka ardhur një nxënës shkollë për praktikë dhe dëshiron të takohet me Ju. Ndalova dhe prita. U përshëndetën dhe u prezantuan me njeri tjetrin në mes masivëve shkëmbore gëlqerorë të Fillim Rrafshit. Quhej Halim Mandri. Ishte nga fshati Shumbat (sot pjesë e komunës së Sillovës), një djalë i ri e simpatik, me flokë të zinj, trup vogël dhe me fytyrë të imët. Edhe me porosi ta kisha kërkuar një person të tillë nuk do ta gjeja. Ja që ndodh dhe kështu. Me Halimin u miqësua shumë shpejt, jo vetën se ishim nga fshatra kufitar por edhe për faktin tjetër të rëndësishëm se ai ishte njeri i sjellshtëm e i papërtuar, i shkathët dhe kurajoz. Çdo gjë që kishte mësuar në libra kërkonte ta materializonte në praktikë. Pyeste dhe kërkonte të dinte në detaje për fenomene të ndryshme gjeologjike që vrojtonim gjatë punës. Biem dakord të kthehemi tek çadra të pushojmë pak, të lemë paisjet e tija

personale dhe të nisemi për në Qafën e Rosnikut, aty ku kisha vendosur të shkoja vetëm, të paktën atë ditë, gjersa të siguroja një punëtorë rilevimi. E njoha me "dhomën në çadër" ku do të flinte, pasi Xhevatit nuk do të rrinte më aty, do të kthehej në shtëpi bashkë me punëtorët e tjerë të kanaleve. Bëjë me zë baxhierin, Imer Shehun, dhe nisemi për marshutë. Marrë me vehte të gjitha paisjet e punës si dhe disa qeska për prova e kampione. Pas një ore udhëtimi ishim pranë Qafës së Rosnikut. Aty do të punonim gjatë. Do të beja një prerje të detajuar të formacioneve gjeologjike si dhe do të vrojtoja me kujdes minaralizimet sulfure te Arsenikut që shfaqeshin qartësisht këtu. Pasi kishim ndërtuar më shumë se gjysmën

moi më me pyetje. Ohu dhe Ju, i pergjigjesha me humor dhe me një farë inati. Ishim në ethe e dhënies së povi-meve. Do mendosh ndonjë majë kodre në Ukrainë e hajde gjeje me 10 pyetje. Pranova dhe ajo filloj të më bëjë pyetje. A ndodhet në Europë? Po. A ndodhet ne Europën Jugore? U mendua pak dhe tha po. A ndodhet në Itali? Po. A është lumë? Po. A ndodhet ne Lombardi? Po. A është lumi Po? Po. Në pyetjen e gjashtë unë e gjeta. Kjo ishte krejt një rastësi. Pas kësaj loje, kështu po e quaj unë, për të më bërë të qesh, sa herë takoheshim, më riprodhonte dialogun duke më thënë: A është në Lombardi, po, a është lumi Po, po. Rradha e "po-ve" i pëlqeu shumë. Kur vazhdoja studimet e larta, u shtrova për disa ditë në spital. Shoqja nuk dinte gjë. Kishte pyetur shokët e mi të konviktin ne godinën 16 dhe ata i kishin treguar. U shtrova ne spitalin ushtarak, në Laprakë. Pas disa ditësh, sa po kishte marrë dijeni se jam shtruar në spital, erdhi dhe më pa. Dolëm dhe u ulëm në një stol të oborrit të spitalit. Gjatë asaj kohe që ndjeji, u interesua për gjithçka që lidhej me shëndetin tim. Më thoshte me humor se pyetje Gjeografie nuk do të të bëjë më, por PO-në e lumit PO nuk do ta harroi gjatë kohë. I ndritnin sytë tek më shikonte kur unë i tregoja se po përmirësohesha. Ndejtëm pranë njeri tjetrit duke biseduar, ne veçti për provimet që na prisnin. Aq sa duheshim dhe respektonim njeri tjetrin, kishim dhe një farë konkurrence në mësimë në kuptimin e mirë të fjalës. Duke me uruar një shërim të shpejt u ndamë. Kur dola nga spitali dhe shkova në shkollë, në fakultet, më takoi dhe më përqafoi. Një përqafoi i atij lloji kur motra përqafohet me vëllain. Në atë kohë shpirtërat dhe zemrat i kishim të pastër. Në qoftë se ndonjë lexues, i jep tjetër kuptim dashurisë sime për atë vajzë dhe të asaj për mua, është i lirë ta bëjë këtë. Por për mua ishte pajfjësia vetë dhe nuk mund ta poshtëroj me ndjenja të tjera, qoftë edhe me më të bukurën e të bukurave - me dashurinë -siç shprehet shkriktari Martini në librin e tij të fundit -Pedagogjik-asit. Ajo ishte dashuri e një lloji tjetër. Në korrik, kur mbaruam studimet, u ndamë dhe morëm emrimet nëpër rrethe të ndryshme të vendit, ku do të kryenin stazhin dhe diplomën. Erdhi koha dhe u paraqita në fakultet për ta mbrojtur atë. Midis shokëve desha të takoj edhe shoqen. Para se ta takoja mora vesh se ishte fejuar. U gëzova shumë, por njëkohësisht diçka më gërvishi në shpirt. Ngjarje dhe vajza të tjera u futën midis nesh. Kundër saj nuk mund të vepronte harresa edhe pse ishte shtyrë në rrathë periferik të kujtesës. Ndodhte që më merrte mall për të, sa më kalonte në mërzë!

\*\*\*

U ngrita kur dëgjova zërin e Halimit tek më thoshte se koha po prishet. Kthehemi në çadër. Fosilin do ta nxjerrim një ditë tjetër. Duhet disa paisje shtesë për ta shkëputur nga gjiri i shkëmbit ku ka "fjetur" për më shumë se 200 milion vjetë. A po jo inxhinier -mu drejtua për tu siguruar, duke menduar se isha edhe specialist i asaj fushe. Kemi ditë plotë për të kryer të gjitha punët. Ndërsa po më thoshte këto fjalë, unë e dëgjova dhe e shikoja ashtu turbullt. Nuk kishim marrë asgjë për tu mbrojtur nga shiu. Ah, thash me vehte: Retë e zeza të Korabit e "mbajtjen fjalën"...! Në çadër u kthyem vonë, të lodhur e të lagur, nga rrebeshet e shiut të bjeshkëve të nalta.

\* Autori i shkrimit është antar i senatit akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Kulla e Llesheve, ashtu si kullat e Markeve dhe Lekeve, shquheshin për besë, trimëri e bujari. Ata ndanin kanun e pleqësi. Këto risi e tradita u trasmetuan brez pas brezi në Zogje të Dibrës.



Nga: ZABIT QAMIL LLESHI

# “Nuk duen “babë”, nuk duen dovet, ato duen shtëpinë e vet”

Me rastin e 170 vjetorit të lindjes MUSTAFA (TUSH) LLESHI

Në kohën kur lufta kundër reformave të Tanzimatit po finalizohet në bilancin e sukseseve të maleve të Dibrës, lindi një tjetër patriot, Mustafai (i njohur si) Tush Lleshi, që gjithë jetën do tia kushtonte çështjes së autonomisë, pamvarësisë, arësimit dhe Atdheut.

Lindi në Zogje të Dibrës në vitin 1850 në një familje të madhe të Grykës së Vogël, Nga gjiri i kësaj familje kanë dalë njerëz të shquar e patriotë, ushtarakë të zotë, heronj, deputetë, diplomatë të shquar, shkencëtarë e profesorë, juristë, arsimtarë, doktorë e inxhinjerë, pushtetarë qëndror e vendor, bujq e blegtorë të dalluar si dhe burra të mencur e trima, që i kanë prirë në luftë dhe pas lufte, fisit, fshatit, Grykës së Vogël, 9 maleve të Dibrës dhe Kombit.

Kulla e Llesheve, ashtu si kullat e Markeve dhe Lekeve, shquheshin për besë, trimëri e bujari. Ata ndanin kanun e pleqësi. Këto risi e tradita u trasmetuan brez pas brezi në Zogje të Dibrës.

Parimi i unitetit i barazisë në mes të njerëzve dhe familjeve, ndihma për kryerjen e punëve në bujqësi, ndërtim, vepra ujitëse, respekti për luftëtarët e të rënë, të moshuarit, miqtë, dashamirësit, fenë dhe predikuesit e saj, ishin nga parimet kryesore të cilat njerëzit kishin parasysh në jetën e përditshme dhe në marrëdhënjet shoqërore midis tyre.

Oda, ashtu si për gjithë Dibrën edhe për malësorët e Zogje, ishte vendi ku shfaqeshin zgjuarësia, trimëria, tradita, kalitej karakteri, shfaqje në përmasat e saj atdhedashuria, por ajo kryente edhe misionin e marrjes e dhënjes së një informacioni të gjërë mbi ngjarjet, luftërat, heroizmin e popullit brez pas brezi.

Rrethanat historike së bashku me ambjentin në të cilin u rrit Tush Lleshi qysh në moshë të re do ta rrjeshtonte patriotin e ardhshëm në krahun më të fortë të shqiptarëve që luftonin kundër pushtuesve osmanë në trihjetë vjetet e fundit të shekullit të XIX<sup>te</sup> (1).

Lufta kundër reformave të Tanzimatit, heroizmi i 9 Maleve në luftën e Drinit, vetmohimi i Cen Lekës e bashkëfshatarëve të tij nga Zogjet lanë mbresa të thella në ndërgjegjen e Tush Lleshit, prandaj në punën dhe luftën që zhvilloi gjatë gjithë jetës së tij ia kushtoi realizimit të idealeve të të parëve, për një Shqipëri autonome, më vehte, të pamvarur, për arësim e përparim të gjithanshëm ekonomik shoqëror.

Ashtu si edhe Liman e Sefer Lleshi (babai dhe gjyshi), Tushi filloi të grumbullojë eksperiencën e tij në luftën për mbrojtjen e trojeve shqiptare, e për këte nderohej dhe respektohej në rrethet patriotike në Dibër dhe më gjërë. Ishte veprimtar i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (dega Dibër), përkrah Iljaz Pashës, Selim Dacit, Sadik Pashë Hoxhollit etj. Ka qenë organizator i disa kuvendeve të maleve të Dibrës, ndërmjet tyre atij të Shupenzes (tek varret), shoqëroi Abdyl Frashërin në Grykë të Vogël dhe Dibër të Madhe për propogandimet e vendimeve të Lidhjes.

Dega e Lidhjes Shqiptare (Dibër) nuk u pajtua me vendimet e Kongresit të Berlinit të vitit 1878. Protesta e saj prandaj ambasadorit francez në Stamboll mban firmën e Mustafa Tush Lleshit (2) krahas patriotëve të tjerë dibranë.

Pas shpërndarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Dibra e Madhe dhe malet e Dibrës nuk i lëshuan armët kundër osmanëve. Meqenëse Tush Lleshi kishte një popullaritet të madh në Grykë të Vogël e më gjërë administrata osmane i dha gradën

Caush në Dibër të Madhe, për të ruajtur qetësinë (3) me mendimin se këtë gjë mund ta bëjë edhe në malësinë e Grykës së Vogël, Grykës së Madhe, Bulqizës etj.



Fshati Zogje i Dibrës ku ka lindur Tush Lleshi dhe djemte e tij Haliti, Pellumbi, Aqifi, Osmani e Iljazi

Në vitin 1881 në Dibër erdhi si Mytesarif, Kadri Pasha i cili e filloi me arrestime, burgosje e internime të patriotëve dibranë, midis tyre edhe Haxhi Jusuf Krifcën. Populli i Dibrës nisi protestat dhe tubimet para kazermave dhe shkuan në xhaminë e Krifcës (fshat pranë Dibrës së Madhe) ku formuluan telegramin për largimin e Kadri Pashës nga Dibra., ndryshe do të sulmollin me armë kazermat qeveritare.

Kadri Pasha u detyrua të hynte në bisedime me Kuvendin e Dibrës i cili delegoi për bisedime Tush Lleshin dhe Osman Demën. Mytesarif nuk i ndërpreu presionet, ndaj arrestoi zaptijtë e Tush Lleshit, Jusuf Lekën nga Zogjet dhe Elmas Danin nga Topojani. Përsëri Tush Lleshi u caktua nga Kuvendi të negocionte me Pashën, për lirinë e dibranëve të arrestuar pa kushte. Kadri Pasha gaboi përsëri, hodhi poshtë kërkesën e të deleguarve të Kuvendit të Krifcës. Në këto kushte, malësoret e armatosur nën komandën e Tush Lleshit e Shaban Demës u grumbulluan në pritje për të sulmuar ushtrinë osmane në Dibër të Madhe.

Vullnetarë të tjerë erdhën nga Bulqiza, Gryka e Madhe, Dohoshishtit, Greva e Melani të komanduara nga Mehmet Durici, Ismail Baloshi e Hasan Zajmi. Afër qytetit ato ishin në gadishmëri për sulm. Në ushtrinë osmane kishte dhe ushtarë e komandantë të rekrutuar nga Tomorrca e Beratit. Një pjesë të mirë prej tyre Tush Lleshi i kish bindur të bashkoheshin me malësorët dibranë, kështu që pjesa më e madhe e tyre kaluan në anën e luftëtarëve dhe u vunë pushkën turqëve. (4)

Kjo ngjarje u përcoll nga rapsodet popullore:

**Tush Lleshi e Shaban Dema**

**Rrafm telat rrema – rrema**

**Rrema - rrema ke doveti**

**Lësho zaptijtë se u ba kiameti**

Porta e lartë u alarmua nga këto lëvizje, aq sa nuk kishte as kohe, as forca për tu balafaquar:

**Isuf Leka e Elmas Dani**

**Para u shkon Maliq Kopani**

**Shkoi haberi ne hiqimet**

**C'ka mileta që bërtet**

Luftëtarët dhe të arrestuarit nuk e donin shtetin osman, por donin Atdheun, trojet, lirinë, dinjitetin dhe shtëpinë e tyre.

**Nuk duen “babë”**

**Nuk duen dovet**

**Ato duen shtëpinë e vet (5)**

Kadri Pashës i mbeti vetëm një rrugë, ajo e largimit të turpshëm dhe populli me sarkazëm tregon nëpërmjet vargjeve se ai iku natën bashkë me gruan e tij e cila u vesh si ushtar për të shpëtuar nga urrejtja popullore.

**Këndon gjeli kikiriku**

**Kadri Pasha natën iku**

**Këndoi gjeli osaman**

**E shoqja e pashës u vesh nizam (6)**

Në vjeshtën e vitit 1882 Dohoshishtit (fshat patriot afër Peshkopisë) protestoi kundër mbledhjes së taksave nga kajmekami i Peshkopisë që njihet në histori si Kryengritja e Dohoshishtit.

Në ndihmë të Dohoshishtit erdhën, nga Reci, Jusuf Doda, nga Bulqiza, Mehmet Durici, nga Zerqani, Sheh Sula, nga Luznia, Llan Tërnova, nga Gryka e Vogël, Tush Lleshi e Mersim Dema. Përsëri Tush Lleshi u ngarkua nga Malet për bisedime, pas tërheqjes së forcave osmane në Peshkopi dhe largimit të një pjese tjetër të ushtrisë në Dibër të Madhe. Marrëveshja e arritur konsistonte në:

1. Prishjen e administratës pro turke në Peshkopi dhe largimin e Kajmekamit e pjesës tjetër të ushtrisë.

2. Të ndërpritej mbledhja e taksave, duke ndërprerë luftën e gjakderdhjen.

Jehona e Kryengritjes së Dohoshishtit, ndihma e singertë e Maleve në mbështetje të kërkesave të drejta të fshatarëve tregoi edhe një herë shpirtin luftarak të malësorëve kundër pushtuesve osmanë dhe bejlerëve e agallarëve vendas. Tush Lleshi qëndroi edhe një muaj në Dohoshisht derisa banorët e këtij fshati filluan jetën e tyre normale. (7)

Për veprimtarinë në shërbim të çështjes së Atdheut, Tush Lleshit, iu rrit akoma me shumë autoriteti dhe prestigji, jo vetëm në Grykën e Vogël por edhe në rrethet patriotike të Dibrës, Kosovës, Manastirit, Elbasanit, Korçës, Strugës dhe Ohrit.

Në Kuvendin e Dibrës të 7 shkurtit 1899, Tush Lleshi jo vetëm u tregua mjaft aktiv por edhe përfaqësonte Grykën e Vogël së bashku me Bajram Marken nga Zogjet dhe Shaban e Jashar Demën nga Homeshi. Këta patriotë përfaqësuan lëvizjen autonomiste dhe i dhanë frymë të re Kuvendit, kundër rrymës së moderuar të bashkëpunimit me administratën os-

mane.

Profesor Kristo Frashëri duke vlerësuar Kongresin e Dibrës thekson:

Përfaqësuesit e rrymës për autonomi (z.II.) në pjesën më të madhe ishin qytetarë, si Selim Rusi, Hamdi Ohri, Shaqir Daci, Shyqyri Qoku, Sefedin Pustina, Shaqir Jegeni, Nurce Pustina, Kadri Fishti e Vebi Agolli, por edhe personalitete që vinin nga malësia si, Jusuf Karasani nga Brezhdani, Sheh Sulejmani nga Zerqani, Tush Lleshi nga Zogjet, Hasan Kaloshi nga Cidhna, Jashar Dema nga Homeshi etj. (8)

Tush Lleshi nuk e ndau luftën kundër pushtuesve osmanë, nga puna për përhapjen e gjuhes shqipe dhe hapjen e shkollave. Ai ishte njeri prej 31 delegatëve të Dibrës në “Kuvendin Popullor” sic u quajt në dokumentat e kohës Kuvendi i Dibrës në përkrahje të Lidhjes së Pejës, por që i avancoi kërkesat ndaj Portës së Lartë. Në mbledhjet e Komitetit të Dibrës u miratuan një varg kërkesash për zhvillim kulturor të kombit Shqiptar, për ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

Më 6 Nentor 1899 në promemorjen që i drejtohej Sulltanit, i kërkohej të themelohej një shkollë shqipe në Dibër, sipas shembullit të Korçës me shpenzimet e vetë shqiptarëve.

Lidhjet me Sait Najdenin, Shyqyri Qokun, Shahin Kolonjën, Dervish Himën, Ibrahim Temon, Hasan Moglicën etj. që mbanin Tush Lleshi e Bajram Markja për sigurimin e abetareve shqip kontribuan në shpejtimin e hapjes së shkollave shqipe në Bllacë, Homesh, Zogje e Gjoricë.

Endrrën për ndërtimin e shkollës shqipe në Zogje e realizuan djemte e Tush Lleshit, Aqifi e Pellumbi, në vitin 1930, me kontributin e tyre dhe me ndihmën modeste të bashkëvendasve arsimdashës.

Kryengritjet e mëdha 1910-1912 dhe lufta për mbrojtjen e kufijve nga shovinistët serbë me 1913 u përcollën me një dëshpërim të madh nga ana e Tush Lleshit. Luftëtarë të rinj rrokën armët për mbrojtjen e trojeve nga kjo familje patriote.

Djemtë e Tush Lleshit, Haliti, Pellumbi, Aqifi, Osmani e Iljazi, ndoqën traditat e të parëve të tyre, Limanit e Sefer Lleshit të vjetër, babait dhe gjyshit të Tushit, duke luftuar kundër pushtuesve serbë, bullgarë e austrohungarezë e më vonë kundër atyre italianë e gjermanë në luftën e dytë botërore. Komandanti dhe Heroi i popullit Haxhi Lleshi, Prijësi e Komandanti popullor Aqif Lleshi, dëshmori i parë tankist Hamdi Lleshi dhe luftëtarët trima, Ymer, Lutfi e Gani Lleshi, bijtë dhe nipërit e Tush Lleshit do të pasuronin biografinë e një shekulli lufte të kësaj familje të madhe patriotike, në mbrojtje të kauzës dhe përparimit të kombit.

Konferenca e Ambasadorëve (1913) ndau jo vetem Dibrën por edhe trojet (pronat) e familjes së Llesheve, në Reshanin prej Banishtit. Këto ngjarje e rënduan me shumë pleqërine e patriotit Tush Lleshi, veprimtarinë e të cilit nuk e panë me sy të mirë edhe bejlerët dhe agallarët e Dibrës. Vdiq në vitin 1915 në Reshan.

Tiranë, Janar 2010

(1) Mojs Murra : Jeta dhe veprimtaria e Aqif Lleshit faqe 12

(2) Mojs Murra : Jeta dhe veprimtaria e Aqif Lleshit faqe 13

(3) Munir Shehu , Punim i cituar faqe 4

(4) Munir Shehu , Punim i cituar, po aty

(5) Sotir Tema , Petrit Najdeni, Seit Najdeni, Tirane 1980 “Seit Najdeni”

(6) Haki Stërmilli, Vepër e cituar, Faqe 15

(7) Munir Shehu, Punim i cituar

(8) Kristo Frashëri , Kumtesë e mbajtur në Peshkopi 01,06,1989. Muzeu Historik Dibër Dosja nr.23 faqe 11.

"Tenxherja" është rrëfim lirik, i pafajshëm dhe imponues, elegjiak dhe ngazëllyes, parodizues dhe tronditës njëkohësisht; "Tenxherja" është kristali bazë, miniatura planimetricke e një shpirti të fuqishëm krijues që, në përplasje me kohët e reja do të vijë duke u zmadhuar, duke u përsosur;

# Spiralja e hijshme e ngjites


Nga: **VIRION GRAÇI**

Dua të rrëfej një Agron tjetër, atë që kam njohur afërsisht tetëmbëdhjetë vjet më parë dhe për romanin e tij më të fundit: "Tenxherja".

Periodikisht kam mbajtur e botuar shënime për autorë e vepra që më kanë lënë mbresa: nga klasikët deri te bashkëkohësit, për shkrimtarë të njohur ose... aspak të njohur publikisht deri tani, nga letërsia shqipe e nga letërsia e huaj.

Ndër autorët që kanë qenë përherë në vëmendjen time është dhe Agron Tufa: poet, romancier, kritik letrar, polemist i palodhur, përkthyes dhe pedagog letërsie. I përmenda përnjëherësh këto fusha ku Agroni papërtueshëm kontribuon dhe shquhet si asnjë tjetër nga brezi i tij pasi dua të rrëfej një Agron tjetër...atë që kam njohur afërsisht tetëmbëdhjetë vjet më parë.

Te hyrja e filologjikut në Tiranë, një djalë i hollë dhe i gjatë si unë, i skuqur në fytyrë kur shkëmbente fjalët e para me të porsanjohurit, i druajtur, krejt i turpshëm dhe i mbyllur në vetvete, (si edhe unë), më foli: mos je Virioni? Jam Agron Tufa. Kështu ka nisur një nga miqësitë e mia më të mëdha. Agroni kish pasion letërsinë e ky pasion e shpinte natyrshëm drejt njerëzish të rinj, të panjohur, drejt botës së reja, të panjohura; gjente botime të rezervuara nga letërsia "dekadente", i lexonte, i shpërndante, i kërkonte me mun-



dim t'i mblidhte përsëri për t'i kthyer aty ku i kish huajtur; gjente sërisht libra të tjerë nga ata të rrallët, të ndaluarit dhe vazhonte të nxiste te të tjerët etjen e fisme dhe shijen e hollë për lexime artistike.

Rastësisht mësova se dhe ai vetë kish poezi të shkëlqyera. Një cikël i botuar te "Zëri i rinisë": më ngeli çuditërisht në mendje ai dyfaqësh gazete, nga vargu i parë deri te vargu i fundit. Kur u takuam për herë të dytë, me të mbajtur hapat para meje Agroni deshi të më freskonte pak kujtesën...jam...Unë e ndërpreva duke përsëritur vargjet e tij që kisha

lexuar te "Zëri": sopata provoi pak tul të bardhë plepi...

Ndryshe nga ne që e mbyllëm ciklin e formimit universitar në qoshkat dhe kthinat e rrënuara të Tiranës arkaike e gjumashe, formimi i Agronit mori rrugë të mirë me kryerjen e studimeve universitare dhe pauniversitare në Moskë. Prej andej u kthye me një roman të shkëlqyer si "Dueli".

Kam shkruar disa herë për këtë roman, jo për hir të autorit, por për shkak të atij vetë, për shkak të "Duelit": triller fantazmagorik, autobiografi, traktat vetjak-estetiko-filozofik, blasfemi ndaj moralit dhe shkrimi artistik, e shumçka tjetër.

Nga Moska Agroni erdhi me shije të shëndoshë letrare dhe kulturore, me vetëdije më të thellë e më të kthjellët për kulturën dhe gjuhën amtare, me shpirt artistik të etur e të arrirë njëkohësisht për t'u hapur denjësisht në botën e madhe letrare; në të përjavshmen e tij letraro-kulturore "Fjala" janë botuar dhjetëra shkrime kritike, analiza letrare, komente; janë botuar dhjetëra cikle poezish të mrekullueshme, tregime, portrete artistësh, polemika dhe recensione që kanë shërbyer dhe do të shërbejnë si pika orientimi për lexuesit dhe studiuesit, për shumë kohë.

Kanë kaluar vite nga dita kur Agroni prezantoi thjesht si lexues, si adhurues librash, si dashamirës i letërsisë artistike e vetëm kaq, asgjë tjetër, ju betohem, asgjë tjetër.

Edhe unë bëja pjesë te ata që shkruanin vetëm për vete, në fshehtësi; para dite talleshim me pjesëtarët e rrethve letrare, mbasdite ulëshim dhe shkruanim ashtu si ata, pa pretendime, vetëm për vete; para dite ironizonim të talentuarit dhe të talentuarat e vetëshpallura me zhurmë, kurse mbasdite a natën vonë, njëlloj si miqtë dhe bashkëmoshatarët tanë i hipnim revan të njëjtit Rosinant. Kanë kaluar vite...

Shumë prej nesh e shtruan kurrizin si mjet ndenjës për idhujt e rinj të epokës së tregut; disa u bënë shqytarë me pagesë e disa cinikë vetëvrasës; shumica braktisi fizikisht atdheun, disa braktisën vetëm idealin e dikurshme; disa u kthyen shëndosh e mirë në paqen e prozaizmit të përditshëm, disa u dashuruan befasisht me gjërat dikur të urreyera; disa udhëtojnë drejt "yjes", rendin sipër resh duke u kapardisur mbi kapica parash të vjedhura, të ndyra; disa të paktë, fare të paktë në numër mbetën sërisht ata që ishin: të sinqertë me veten, të dashuruar pastërtisht me jetën, të bashkuar marrëzisht me letërsinë, në një lidhje dramatike, të hijshme dhe flijuese. Agroni është ndër të zgjedhurit, ndër të mbijeturit e pakët; i shkruaj këto fjalë sepse njoh jetën e tij, i shkruaj këto fjalë respekti pasi kam lexuar edhe romanin e tij më të fundit: "Tenxherja".

Tre vjet më parë, kur po nxitoja rrugicave të ish bllokut për një takim pune te botuesit e mi, te "Shekulli",

ma rrëfente udhës atë që mund të quhet historia bazë e romanit: mendova se gurët e çmuar të atij mozaiku liriko-dramatik po zbuloheshin për herë të parë dhe të fundit vetëm për mua; u tremba për të dhe për historinë e tij familjare aq sa e ndërpreva: të lutem Agron, mos më trego më tani, shkruaji ndonjëherë të gjitha këto, shkruaji, ia vlen...Lexuesit e kanë në duar tani atë histori të shndërruar mjeshtërisht në roman, botuar e prezantuar me dinjitetin dhe profesionalizmin e duhur.

"Tenxherja" nuk është roman botëkuptimor, nuk është roman-lumë, roman-ide, roman-eksperiment; nuk është as sagë e mirëfilltë familjare; është rrëfim lirik, i pafajshëm dhe imponues, elegjiak dhe ngazëllyes, parodizues dhe tronditës njëkohësisht; "Tenxherja" është kristali bazë, miniatura planimetricke e një shpirti të fuqishëm krijues që, në përplasje me kohët e reja do të vijë duke u zmadhuar, duke u përsosur; ky libër i vyer nuk do të ndihmojë shumë në qëndrimin vertikal të autorit përkrah të mëdhenjve të letërsisë në botë, por do të jetë rrëfim i pazëvendësueshëm për autorin dhe për të ngjashmit e tij, sikurse është e pazëvendësueshme nënkresa e gjyshit pranë oxhakut të vatrës familjare, siç është i pazëvendësueshëm prehri i nënës për të cilin, të gjithë, pa përjashtim do të kemi mall e nevojë në jetë të jetëve.

Gazeta "Shekulli"

Post hapjes së Ekspozitës së trashigimisë kulturore dhe natyrore në Dibër të Madhe dhe Rekë

## Gabime që nuk duheshin bërë

Në organizim të Ministrisë për Kulturë të Maqedonisë, në Hamamin e qytetit në Dibër të Madhe, më datë 15 dhjetor 2009, u hap ekspozita me fotografi "trashëgimia kulturore dhe natyrore e Dibrës së Madhe dhe e Rekës". Kjo ekspozitë u realizua nga Këshilli i Europës në kuadër të programit për bashkëpunim teknik dhe konsultime në nëntë vende të Evropës Juglindore. Ky projekt pilot për zhvillim lokal bëhet me qëllim të aktiviteteve për zhvillim të qëndrueshëm mbi bazën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. E tërë kjo është për tu përsëritur.

Mirëpo po ti hedhim një sy kritik këtij aktiviteti do të hasim në shumë lëshime përmbajtjesore të qëllimshme apo të lëshuara nga pakujdesia.

Në materialin që iu dha përfaqësuesve të medimeve vetëm në gjuhën maqedonishte, në rreshtin e 21 ku numërohen objektet profane nuk përmendet fare prania e xhamive edhe pse pjesa dëmtuese e kësaj popullate i përket religjionit islam.

Në fletushkën e ilustruar me tekst dhe fotografi, "Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore në Dibër të Madhe dhe Rekë" e botuar nga Ministria për Kulturë e Republikës së Maqedonisë - Drejtoria për mbrojtjen të trashëgimisë kulturore, fletushkë vetëm në gjuhë maqedonase edhe pse mund të ishte edhe në gjuhën shqipe dhe pse jo edhe turke me redaksi në krye



Xhamia e Hynqarit.

të së cilës qëndron emri Pasko Kuzman, fletushkë që iu dha të pranishmëve. Në këtë fletushkë vërehen mangësi të qëllimshme apo të paqëllimshme në përmbajtjen e tekstit dhe të fotografive të paraqitura.

Ne faqen e dytë në tekstin ku flitet për Komunën e Dibrës së Madhe dhe të Mavrovë - Rostushës, në rreshtin e 12 të kapitullit "Rajoni i Dibrës së Madhe dhe i Rekës", ku flitet për strukturën e popullsisë multietnike, fillohet me maqedonët, shqiptarët, turqit edhe pse shumica dërmuese e popullatës është me kombësi shqiptare.

Në kapitullin "Trashëgimia natyrore", nuk flitet fare për fshatrat shqiptare në Komunën e Dibrës së Madhe që ndodhen në rripin kufitar me Shqipërinë, të cilat gjithashtu karakterizohen me bukuri magjepsë, me burime ujore, me florë dhe faunë të bujshme. Për këto fshatra përveç se nuk janë përmendur fare nuk ka as edhe një fotografi të vetme.

Në kapitullin "Trashëgimia Kulturore", xhamia më e vjetër në Dibër të Madhe, Xhamia e Hynqarit, xhami e shekullit të XV, është shkruajtur Xhamia Hynqer që është tejet e gabueshme.

Në fotografitë e paraqitura nuk shohim as një xhami me minare, përveç një fotografie që paraqet varret e Xhamisë së Hynqarit dhe fotografinë që paraqet

Hamamin e Ri të qytetit. Ndërkaq në këtë kapitull janë paraqitur pesë foto imponante të kishave dhe të manastireve ortodokse.

Në këtë fletushkë shkruhet vetëm për shpirtë karakteristike të Rekës në fshatrat Gjare, Tresaq, Llazaropole, Jançe dhe fshatrat mijake kryesisht me popullatë maqedonase dhe nuk përmenden fare fshatrat shqiptare të Komunës së Dibrës së Madhe që gjenden në rripin kufitar me Shqipërinë, siç janë Taraniku, Sushica, Bomova, Kojnara, Taraneshi, Sollokiçi, Spasi dhe Ame, fshatra ku mund të gjenden objekte interesante për tu rinovuar, siç është kulla e Salë Markes etj, dhe ku ka resurse të shumta natyrore që nëse u vihet dorë, do të përbënin potencial për zhvillim ekonomik, të turizmit dhe kulturor të kësaj zone.

Sa për informim në fshatrat maqedonase të Rekës janë bërë investime të mëdha në infrastrukturë, në rrugë ujësjellës, elektrifikim dhe telefoni. Rrugët janë të asfaltuara deri te dera e çdo shtëpie.

Për dallim nga këto në fshatrat shqiptare të Dibrës së Madhe nuk është bërë asnjë investim në infrastrukturë, në asfaltimin e rrugëve, në shumë fshatra nuk ka ujësjellës, elektrifikim e të mos flasim për telefoni.

Evropa një ditë do të vijë edhe te na dhe do të habitet kur do të shikojë këto dallime të mëdha ndërmjet fshatrave të pispillosur dhe atyre të reckosur.

Rexhep TORTE

Shkencëtarët tanë dhe mendimtarët tanë, si profesor Hasan Çipuri, hedhin ura bashkimi dhe vëllazari mi edhe me serbët. Kështu, në këtë dritë duhet parë puna e tij shumë voluminoze për hartimin e dy fjalorëve që i shërbejnë njohjes së shqipes nga serbët dhe njohjen e serbishtes nga shqiptarët.

# Profesor me vepra, jo veç me tituj dhe grada

Nga: **SHAQIR SKARRA**

**E** kam njohur vonë, pas viteve nëntëdhjetë profesor Hasan Çipurin. Pra, për të bërë këtë shkrim për të, nuk më shtyri asgjë tjetër, përveç nderimit që kam për njerëzit e ditur dhe të përkushtuar për punën dhe profesionin e tyre. Në fakt shkrimi e pati një shkak dhe si pikënisje e tij duhet marrë fakti që më ra rastësisht në dorë një curriculum vitae i profesor Hasan Çipurit, nëpërmjet të cilit u njoha me jetën dhe veprat e tij. E kam pas ditur edhe më parë që Hasani punon në ushtri, se merrej me punë shkencore të natyrës ushtarake, se ishte njeri punëtor që kishte arritur suksese në profesionin e tij. Por nuk kisha ditur se ai kishte botuar aq shumë vepra jo vetëm prej atyre që lidhen me artin ushtarak, por edhe vepra të tjera me një diapazon më të gjerë. Por për këto do të flasim më poshtë.

Këtu në këtë hyrje dëshiroj të them se jam takuar dhe kam biseduar me shumë profesorë, disa vërtet të nderuar para të cilëve përkulem me respekt, por edhe mjaft prej atyre që nuk e meritojnë gradën që kanë marrë. Këta të fundit prezantohen me mburrje, por, kur vjen puna për të treguar se ç'Vepra kanë bërë, ç'kontribut kanë sjellë për shkencën dhe kulturën sipas profilit që kanë, ndihen ngushtë dhe përmendin ndonjë disertacion që nuk e ka parë kurrë dritën e botimit ose përmendin ndonjë artikull në filan gazetë apo revistë "prestigjioze" dhe me kaq u mbyllet goja. Natyrisht këta profesorë dhe doktorë gëzojnë edhe të mirat materiale, që burojnë prej gradave dhe titujve që kanë dhe bash për këtë fakt nuk u bëhet vonë se ç'mendojnë dhe thonë të tjerët për ta. Por këtu faji nuk është vetëm i tyre, por edhe i mënyrave se si jepen titujt dhe gradat, të cilat edhe sot e kësaj dite u jepen shumë personave që nuk shquhen në fushën që mbulojnë dhe nuk kanë dhënë kurrëfarë kontributi për të shënuar progres më ndonjë drejtim.

Në curriculum të profesor Hasan Çipurit janë shënuar titujt dhe gradat shkencore, detyrat funksionale që ka kryer, dekorimet, që janë bërë etj. Më vjen mirë që profesor Hasani i janë dhënë titujt dhe grada shkencore, që ka kryer detyra të larta shtetërore, që i janë bërë ndere dhe dekorime të herëpashershme, se më duket se të gjitha këto i ka merituar.

Po unë nuk do të merrem me to dhe nuk janë këto që më bëjnë përshtypje. Të gjitha sa përmenda më lart jepen nga të tjerët: nga shteti, nga komisionet, nga dhjetra organizma që mbajnë në fokus jetën e njerëzve të suksesshëm, dhe japin dekorata e tituj sa herë që ju duket se kjo është e nevojshme. Por të gjitha këto edhe mund të mos i jepen një njeriu edhe kur ai i meriton plotësisht ato. Po të pranojmë se këto punë bëhen me ndërgjegje dhe drejtësi del që në këtë jetë nuk ka njerëz të pavlerësuar. Por faktet tregojnë të kundërtën: pas shumë vitesh, ata që janë vlerësuar lart në kohën e tyre,



zbehen e harrohen, dhe marrin shkëlqim e nderohen të tjerë që në kohën e vetë nuk i ka përfillur askush. "Ka shumë që fitojnë famë, - thotë Lesingu, - kurse të tjerë e meritojnë atë." Prandaj edhe D'Alberto shkruan: "Tempulli i famës banohet prej atyre të cilët, sa ishin gjallë, nuk pranohen atje, dhe, prej shumë pak të gjallëve, që, kur vdesin, nxiren prej andej." Shkurt, titujt, gradat, dekorat etj., nuk më bëjnë kurrëfarë përshtypje dhe nuk do më nxisinin kurrë për ta bërë këtë shkrim. Ato që më nxitën dhe që nuk mund të anashkalohen janë veprat e shumta të Çipurit. Unë u gëzova që ky është një profesor me vepra, një pjesë të madhe të të cilave ia ka diktuar puna dhe funksionet që ka kryer për të shënuar progres në fushën që ka mbuluar. Me pak fjalë, dijet e tij janë materializuar. Dhe kjo, për mendimin tim, është shkencë e vërtetë.

Prof. dr. Çipuri është marrë kryesisht me leksikografinë, pra, me fushën e fjalorëve që është një nga punët më të vështira dhe më të lodhshme në shkencat filologjike. Hartimi i fjalorëve kërkon një përgatitje të lartë shkencore, një punën të lodhshme dhe mbi bazën e një metodike të caktuar. Nuk është vetëm njohja e mirë e gjuhëve të huaja që të bën hartues fjalori, por një njohje e thellë, në radhë të parë, e gjuhës amëtare, pa të cilën nuk mund t'u drejtohesh gjuhëve të huaja.

Përveç artikujve të shumtë në shtypin shkencor dhe në atë publicistik, që kapin mijëra faqe, prof. Hasan Çipuri ka edhe shumë vepra, ku vendin kryesor e zënë ato në funksion të shkencës ushtarake, kryesisht fjalorë termash, siç janë: Terminologjia ushtarake e gjuhës shqipe-monografi, Fjalori ushtarak serbokroatisht - shqip, Fjalori ushtarak italisht-shqip, 15 fjalorë terminologjikë disa gjuhësh të llojëve të forcave, armëve e shërbimeve, Fjalori i termave ushtarake të NATO-s, anglisht-frëngjisht-shqip dhe anasjelltas, Fjalori i shkurtesave dhe akronimeve të NATO-s (në pesë gjuhë), Fjalori i termave të përgjithshëm ushtarakë shqip - anglisht, anglisht - shqip. Këto fjalorë termash kanë rëndësinë e vet dhe i kanë shërbyer destinacionit për të cilin janë hartuar. Autori ka har-

tuar edhe fjalorë të tjerë të kësaj natyre, domethënë në funksion të përsosjes dhe modernizimit të artit ushtarak. Me këtë literaturë sigurisht janë njohur dhe kanë punuar kuadro të shumtë të këtij sektori. Por puna më e madhe në fushën e artit ushtarak më duket se është konkretizuar në hartimin e 6 teksteve për gjuhën serbo-kroate për Akademinë Ushtarake dhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Ky autor ka përballuar me dinjitet shkencor 100 zëra enciklopedikë për Fjalorin Enciklopedik Ushtarak, dhe 60 zëra enciklopedikë për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, botim II, që është një punë sa e madhe, aq edhe shkencore.

Me gjithë këtë, mua më duket se puna e vërtetë shkencore, e rëndësishme për profesor Hasanit ka filluar me hartimin e Fjalorit serbisht - shqip, me 40000 fjalë e shprehje, duke vazhduar me Fjalor shqip-serbisht, me 45 mijë fjalë dhe 25.000 shprehje frazeologjike. Këto janë punë kolosale dhe diturore që shërbejnë për të gjithë ata që janë të interesuar për gjuhën serbe e gjuhën shqipe, pra, ky është një kontribut i madh në fushën e kulturës dhe të gjuhës, por jo vetëm kaq. Për kushtet e rrethanat e Ballkanit, duke pasur parasysh historinë midis dy popujve të Ballkanit, atij shqiptar dhe serb, histori mjaft tragjike që është shënuar me lumenj gjaku (natyrisht, jo për faj të shqiptarëve), hartimi këtyre fjalorëve merr një rëndësi të veçantë. Nuk di nëse janë marrë apo po merren linguistët dhe leksikografët serbë me hartimin e fjalorëve serbisht - shqip, nuk di nëse në universitetet e Serbisë mësohet gjuha shqipe, siç mësohet serbishtja tek ne, por akti i profesor Çipurit është jo vetëm kulturor e shkencor, por edhe politik me domethënie të madhe, sepse mbi lumenjt e gjakut ndërton ura vëllazërimi e paqeje, që ballkanasit të shkojnë si miq tek njëri - tjetri, të shkojnë jo vetëm biznesmenët dhe politikanët, po kulturat dhe njerëzit e kulturave në të dyja anët. Ballkanasit, para se të integrohen në Europë, duhet të integrohen me njëri-tjetrin. Por kjo ndodh jo vetëm kur respektohet integriteti dhe pavarësia e çdo shteti, por edhe identiteti i secilit popull dhe dinjiteti i secilit person.

**Puna e jashtëzakonshme e profesor Hasan Çipurit e bën atë të nderuar në fushën e hartimit të fjalorëve, sepse fjalorët janë ura komunikimi midis popujve dhe kulturave. Profesor Çipuri e ka provuar penën e tij edhe në fushën e përkthimit dhe ia ka dalë mbanë me sukses. Përkthimet kanë qenë të karakterit historik dhe ushtarak, po nga gjuha serbe dhe ajo kroate. Dhe nuk ka përkthyer pak, por dymbëdhjetë libra, sikur përkthimi të ishte puna e vetme e tij. Kjo është një përpjekje e madhe që i ka kushtuar profesorit plot lodhje e shqetësime, net pa gjumë, që veç ata që kanë bërë punë të mundimshme mendore e dinë.**

Edhe Europa Perëndimore që sot paraqitet homogjene, pa kufinj, e bashkuar, gjatë rrjedhave të historisë ka kaluar shumë ngjarje tragjike që i armiqësuan popujt e këtij rajoni. Por perëndimorët ditën të kapërcejnë mbi lumenjtë e gjakut shumë më herët dhe më me pak dhimbje.

Sa më parë të ndodhë kjo edhe për Ballkanin, aq më mirë do të jetë për të gjithë. Në këtë kuptim profesor Çipuri ka dhënë kontributin e tij të madh, dhe ai me të drejtë mund të konsiderohet ambasador i paqes dhe i miqësisë. Një filozof thotë se edhe në dashuri duhet të jesh i pari, duhet të duash më shumë se sa të duan. Të mos e keqkuptojnë nacionalistët shqiptar as profesor Çipurin për punën shumë të madhe që ka bërë, dhe as mua për këtë koment që bëj në lidhje me punën e tij. As unë, as ai nuk themi që e kaluara shumë e dhimbshme duhet harruar. Martin Luther King-u ka thënë disa fjalë të arta për harrimin dhe faljen. Fjalët: "Po të fal, por nuk do të harroj kurrë atë që bëre, nuk shprehin natyrën e vërtetë të faljes, - thotë ai. Sigurisht, nuk mund të harrohen kurrë, nëse kjo do të thotë të fshish krejtësisht diçka nga kujtesa; pra, kur falim, ne harrojmë, në kuptimin që veprimi i keq nuk përbën më një bllok mendor që pengon një marrëdhënie të re". Dhe më tej: "Errësira nuk mund ta dëbojë errësirën; vetëm drita mund të bëjë dritë. Urrejtja nuk mund ta dëbojë urrejtjen, vetëm dashuria mund ta bëjë." Kjo është rruga nga ecet dhe këtë na tregon profesor Çipuri me veprat e tij.

Ndryshe, krejt ndryshe nga profesori ynë i nderuar, ka vepruar shkrimtari më i madh serb, Ivo Andriq, fitues i çmimit Nobel, që ka hartuar projektin famëkeq për zhdukjen e Shqipërisë nga harta e Ballkanit, duke e ndarë atë midis Italisë dhe Jugosllavisë. Kjo ndarje ishte zgjidhje një herë e përgjithmonë edhe për problemin e Kosovës, dhe përgjithësisht për gjithë shqiptarët në Jugosllavi, sepse shqiptarët do të asimiloheshin, kurse një pjesë do të shpënguleheshin për në Turqi. Këtë projekt famëkeq Ivo Andriqi e ka hartuar në vitin 1939, kur ende nuk e kishte marrë çmimin Nobel. Një figure të tillë, që projektonte zhdukjen

e popujve, nuk duhej t'i jepej çmimi më i lartë, por ja që ju dha, çka vërteton edhe një herë mosbesimin tim për dekoratën, madje edhe për çmime shumë prestigjioze si ai Nobel. Kurse Vasa Çubrilloviqi trajton në projektin e tij qëndrimin që duhej mbajtur ndaj pakicave kombëtare në Jugosllavinë e Pas Luftës II Botërore, dhe arrin në përfundimin që këto pakica kombëtare (siç quan ai edhe shqiptarët në trojet e veta në Kosovë dhe në Shqipërinë lindore), duheshin shpërngulur nga Jugosllavia dhe tokat shqiptare të populloheshin nga serbët. Kjo shpërngulje e projektuar para shumë vitesh, u zbatua në fakt nga Millosheviçi.

Qe dora e Zotit dhe këmbëngulja e ish-presidenti Klinton që e ruajtën popullin e Kosovës nga shfarosja e plotë.

E pra, me gjithë këto, shkencëtarët tanë dhe mendimtarët tanë, si profesor Hasan Çipuri, hedhin ura bashkimi dhe vëllazari mi edhe me serbët. Kështu, në këtë dritë duhet parë puna e tij shumë voluminoze për hartimin e dy fjalorëve që i shërbejnë njohjes së shqipes nga serbët dhe njohjen e serbishtes nga shqiptarët.

Puna e jashtëzakonshme e profesor Hasan Çipurit e bënë atë të nderuar në fushën e hartimit të fjalorëve, sepse fjalorët janë ura komunikimi midis popujve dhe kulturave. Profesor Çipuri e ka provuar penën e tij edhe në fushën e përkthimit dhe ia ka dalë mbanë me sukses. Përkthimet kanë qenë të karakterit historik dhe ushtarak, po nga gjuha serbe dhe ajo kroate. Dhe nuk ka përkthyer pak, por dymbëdhjetë libra, sikur përkthimi të ishte puna e vetme e tij. Kjo është një përpjekje e madhe që i ka kushtuar profesorit plot lodhje e shqetësime, net pa gjumë, që veç ata që kanë bërë punë të mundimshme mendore e dinë. Longfelloi për këta njerëz shkruante:

**"Lartësitë e arritura nga njerëzit e mëdhenj**

**Nuk u arritën me një kërcim të befë.**

**Por ata, ndërsa shokët flinin, Mudoleshin drejt lartësisë gjatë natës."**

# Mjeku i pagabueshëm

## letërsi

1

Tregim nga **XHA FER MARTINI**

Kishte qenë një burrë që e quanin Nelë Kazani, por i thonin Nelë Akshami, me kuptimin njeri me fat të ngrysur që nuk ka parë kurrë një të mirë në jetë. Nela e pranoi mbiemrin e ri si kishte pranuar hallet e shumta që e plakën para kohe. Ai ende nuk i kishte mbushur të dyzetat, por dukej si pesëdhjetëvjeçar: i thinjur, me fytyrën plot rrudha dhe pak i kërrusur. Nela kishte nëntë fëmijë, se në dhjetë vjet martesë e shoqja, një dërdënge, kishte pjellë çdo vit. Nela, me gjithë hallet shumta, kur binte fjala për të shoqen, bënte shaka e thoshte se ajo mbetej me barrë sikur vetëm pantallonat t'i hidhte sipër.

Nela kishte pak tokë dhe, megjithëse punonte më shumë se të tjerët, mezi bënte bukën për pesë muaj. Pastaj me shakull në shpinë blejë këtu e blejë aty. Kur nuk kishte parë, shiste prodhimin e arës që sapo e kishte mbjellë: u thoshte atyre që kishin drithë që do t'ua jepte shenikët me misër kur të binte në bukën e arës së vetë. Kur vinte koha për ta korrur, ai nuk gëzohej si çdo bujk tjetër, se më shumë se gjysmën e misrit e kishte borxh. Njerëzit talleshin me të dhe thonin që Nelë Akshami e hante arën jeshil, kur bimët sapo kishin dalë nga toka. Dhe vërtet ashtu ishte, prandaj Nela ulte kokën dhe heshte.

Një vjeshtë, si pagoi drithin borxh, pa se nga ogradja, e vetmja arë që kishte, i mbetën tetë kosha misër që nuk e çonin as një muaj me bukë. Ai u ul rrafsh në tokën e lagësht nga bryma dhe iu lut Zotit:

- O Zot, dërgoma vdekjen të më marrë, se kështu nuk jeto het.

Zoti ia dëgjoi lutjen dhe ja ku para tij u shfaq engjëlli Xhebrail që merrte jetën e njerëzve.

- Më thirrë?- e pyeti ai Nelë Akshamin, duke menduar se do ta hante fjalën siç kishin bërë mjaft të tjerë, që , ndonëse kishin kërkuar të vdisnin, kur u kishte shkuar pranë, u ishte marrë goja nga frika.

- Të thirra, po, të thirra, - i tha Nelë Akshami pa ia bërë tërr syri.

- Domethënë të është mërzi tur jeta dhe do të vdesësh?- e pyeti Xhebraili.

- Po, po, dua të vdes një minutë e më parë, - tha i vendosur Nelë Akshami.

- Pse do të vdesësh? Je ende i ri. Mund ta gëzosh jetën.

- Kjo imja është jetë qeni, nuk kam ç'e dua. Bile qentë jetojnë më mirë se unë. Kam kaq shumë halle, sa nuk mund t'i përballoj. Kam një copë tokë, por me të nuk mund t'i mbaj fëmijët as me bukë, pa lëre pastaj të mendosh për gjërat e tjera. Punoj dhe robtohem, por çdo ditë vjen më e keqje se tjetra. Më mirë t'i jap fund një herë e mirë.

Engjëlli Xhebrail i tha:

- Në qoftë se nuk jeton dot si bujk, bëhu mjek, fito pasuri dhe plotësojua fëmijëve nevojat që kanë.

- Unë mjek?! Po si mund të bëhem mjek unë që nuk di as të shkruaj, as të lexoj?

2

- Nuk ka nevojë të kesh shkollë, të mësoj unë si të veprosh.

- Po hë, si të bëj?- e pyeti Xhebrailin Nelë Akshami dhe interesi për jetën iu zgjua menjëherë.

- Kur të sëmuret dikush, ti shko dhe shikoje. Unë do të jem aty, pranë të sëmurit, por i padukshëm për të tjerët. Vetëm ti do të më shikosh. Po qëndrova tek koka e të sëmurit, ai nuk jeton më, do të vdes; po qëndrova tek këmbët e tij, do të shërohet edhe sikur të jetë shumë rëndë. Të sëmureve që nuk kanë për të vdekur, jepu të përdorin ndonjë ilaç popullor që nuk bën as mirë as keq. Dalëngadalë do të fitosh besimin e njerëzve, që do të të mbushin me para dhe dhurata. Shkurt, do të bëhesh pasanik, dhe do ta gëzosh jetën me gjithë grua dhe fëmijë.

I pari në katund u sëmur Lepe Kucurri, një pasanik, që nuk la mjek pa marrë, por të gjithë i kishin hequr shpresat se ai do të shpëtonte. Kishte dhimbje të forta barku dhe përpiqej si zorra në prush. Kur e kapte ajo dalldia e madhe, lahej në djersë dhe mezi mbushej me frymë. Vdekja e tij dukej punë ditësh. Katundarët dhe dashamirët e kishin parë dhe vazhdonin ta shikonin. Lepe Kucurri nuk merrej vesh me ta, se rrallë herë binte në mend.

Shkon një mbasdarke edhe Nelë Akshami për ta parë. Nelës, si fukara që ishte, nuk ia varte njeri. Veç nuk i thonin që të ngrihej dhe të dilte. Xhebraili ishte aty, pranë shtratit të të sëmurit, tek këmbët. Nela mori guxim që ta përpushte edhe ai një herë mexhelisin e burrave, ku shkonte rrallë dhe nuk përfillej. Me gjithëse ishte njeri shpirtmirë, deshi t'i poshtërojë ata që e kishin poshtëruar gjithë jetën. Por fjala poshtërim është e rëndë për Nelën. Ai deshi të vërë në vend dinjitetin e humbur, të paktën të fitonte sërisht mbiemrin që kishte pasur dhe të mos e quanin Nelë Akshami. Këtë mbiemër ia kishte vënë ai, Zebek Beku, që rrinte në krye të vendit dhe përdridhte mustaqet. Vinte i dyti për pasuri në katund mbas Lepe Kucurrit. Zebeku e kishte dajë Lepe Kucurri dhe kishte vendosur t'i qëndronte tek koka derisa të jepte shpirt. Kishte qëndruar dy javë, nuk mbeteshin, sipas tij, edhe dy ditë sakrificë. Por Nelë Kazani nuk pyeti për mustaqet e Zebek Bekut.

- Qysh dukesh, o Lepe Kucurri?- iu drejtua të sëmurit.

Pyetja që për t'u habitur, se, kur tjetri përpiqej si zorra në prush, kuptohet se si është. Burrave iu duk e panevojshme pyetja e Nelës, por, fukarenjve si ai, ua falnin edhe ndonjë sjellje të pahijshme, se kjo vinte ngaqë ata nuk rrinin nëpër oda dhe mexhelise. Po atë pyetje nuk e përtypi Zebek Beku.

- Nuk e shikon qysh është, or Nelë Akshami. Apo kishe edhe ti një fjalë për të thënë?

- Ti rregullo gojën se unë nuk jam Nelë Akshami, por Nelë Kazani, - tha me plot gojën Nela duke e vështruar Zebekun në sy.- Unë për të shikuar dhe për të kuptuar të sëmurin, jam më i ditur se ti.

3

Nelë Kazani përmes habisë së përgjithshme i hoqi sytë nga Zebeku sikur nuk e vlente të merrej me të dhe përfshiu me një shikim burrat e tjerë dhe e ndali vështrimin tek djali i madh i Lepe Kucurrit, Uk Kucurri. I habiti të gjithë me atë që tha:

- Lepe Kucurri mbas dy-tri ditësh do të ngrihet në këmbë të veta dhe mbas një jave do të mbajë qetë, nëse e ka marrë malli për atë punë.

Habia tek burrat u bë aq e madhe sa ata panë njëri-tjetrin në sy. Fjalët e Nelës i dëgjoi edhe i sëmuri, për të cilin të gjithë kujtonin se i kishte shkëputur marrëdhëniet me këtë botë. Ai u kacle pak dhe mundi të shikojë Nelën në sy.

- Më dëgjove çfarë thashë?- e pyeti Nela.

I sëmuri mbylli dhe hapi sytë sikur donte të thoshte se e kishte dëgjuar. Goja e kishte lënë.

- Mos m'i mbyll sytë ashtu, por hapi mirë se do të ngrihesh.

Fjalët e Nelë Kazanit patën një efekt të çuditshëm tek i sëmuri: ai vërtet i hapi sytë, madje edhe foli për herë të parë që nga dita kur kishte rënë në shtrat:

- A vërtet, or Nelë?

- Si buka që hahet,- tha Nela i vendosur.

Nela u kthye nga Uk Kucurri dhe i tha:

- Merrni ca gjethe ftoi, zieni në ujë, ëmbëltojeni ujin me pak sheqer dhe ia jepni të sëmurit. Kështu?

- Kështu, - tha Uk Kucurri me një zë që tregonte se do t'i bindej atij urdhëri të atij burri që krejt papritur u ngrit mbi të gjithë burrat e tjerë.

Nelë Kazani u ngrit në këmbë pa i kërkuar leje zotit të shtëpisë, Uk Kucurrit, dhe tha:

- Tani ma bëfshi natën e mirë të gjithë.

Çfarë u tha atë natë, do të fshihej nga fshesa e kohës, sikur mbas dy ditësh Lepe Kucurri të mos ishte ngritur në këmbë. Madje kishte edhe pamje të mirë, dukej sikur nuk kishte vuajtur asnjë ditë. Uk Kucurri mori dashin pesëdhjetëokësh dhe katër barrë me drithë dhe ia çoi Nelë Kazanit në derë. Kështu, ku shkonte dhe shikonte të sëmuret, Nelë Kazani e thoshte fjalën e tij dhe ajo dilte pa një pa dy.

U rrit nami i Nelë Kazanit. Tani nuk ia mbante kujt t'ia ndryshonte mbiemrin. Kur dikush sëmurej, Nelë Kazani i çonin kalin dhe e merrnin si të ishte aga. Asnjë mjek dhe asnjë njeri nuk ishte nderuar dhe nuk ishte mbushur me dhurata si ai.

Nela vazhdonte t'u jepte ilaçe atyre të sëmureve që u qëndronte Xhebraili tek këmbët. Dhe ilaçet e bënin efektin menjëherë. Kaluan gjashtë muaj dhe atij nuk i kishte rastitur që të shikonte ndonjë të sëmure të cilit Xhebraili i qëndronte tek koka. Por edhe ajo ditë erdhi.

Sut Balliu, megjithëse ishte burrë dyzet e pesë vjeç, gjuante me llastiqe zogjitë e

4

malit që rrinin nëpër pemë. Një ditë, guri i vogël, sa një kokërr lajthie, me të cilin deshi të qëllojë zogun, ktheu nga trangu i manit dhe i ra në ballë. I hapi një plagë fare të vogël prej të cilës nuk dolën më shumë se dy-tri pika gjaku. Suti nuk i vuri vesh asaj plage aq të cekët dhe të vogël. Por mbas disa ditësh ndjeu disa ankesa të vogla, që ia mori vesh edhe familja. Djali i Suti shkoi dhe mori me kalë Nelë Kazanin. Suti ishte shëndoshë e mirë në krye të vendit, tek oxhaku, dhe pinte kafe dhe duhan.

- Or Nelë, të munduam kot, por qofsh i nderuar që erdhe, - i tha Sut Balliu.

- Jo, bre, bashi i mikut, për mua mos të të vijë keq. Shyqyr që qenke më mirë, - tha Nelë Kazani dhe shtoi: - Por që të bindem se nuk ke asgjë, ti duhet të shtrihesh në shtrat. Vetëm aty e ndaj unë shapin nga sheqeri. Nuk di si të gjykoj kur njerëzit nuk kanë zënë shtratin.

- Nuk kam asgjë, pse të shtrihem?

Ata të familjes, që të nxirrnin merakun, e kandisën Sut Balliun të hynte në shtrat sikur të ishte i sëmure rëndë. Sa u shtri Sut Balliu, pranë shtratit i erdhi Xhebraili dhe i qëndroi tek koka.

- Mirëmbetësh, o Sut, - i tha Nelë Kazani atij dhe doli nga oda.

Suti dhe familjarët e tij kujtuan që Nelë Kazani nuk kishte çfarë të thoshte se kuptohej që Suti nuk ishte sëmure.

Djali i Suti që e kishte marrë me kalë, doli ta vinte prapë në kalë dhe ta çonte deri të shtëpia. Kështu vepronin të gjithë. Do t'i jepte edhe paret, se i takonin. Por Nelë Kazani as paret nuk i mori, as në kalë nuk hipi.

- E di si është puna, - tha ai duke vështruar ndër sy djalin e ri.- Suti mbas një jave ka për të vdekur. Bëhuni gati.

Djali ishte i ri dhe nuk e mbajti fjalën ndër dhëmbë. Por më mirë që nuk e mbajti se vërtet në krye të javës Sut Balliu vdiq. Në mort burrat mbanin në gojë çfarë kishte thënë Nelë Kazani dhe autoriteti dhe pasuria e tij veç vinin duke u shtuar.

Kaluan shumë vite dhe Nelë Kazani po i ndiente shije të madhe jetës. Kudo i ftuar, i nderuar dhe i shpërblyer, por edhe punën e bënte të madhe. Kurrë nuk kishte gabuar, kurdoherë i kishte dalë fjala. Për të sëmuret, që do të vdisnin, Nela u thoshte familjarëve të mos shpenzoheshin kot, por të përgatiteshin për mort. Edhe kjo vlerësohej shumë dhe pothuaj ishte baras me ata që i shëronte.

Një natë u zgjua në gjumë i larë në djersë dhe me dhimbje të forta në kraharor. Kur hapi sytë, pa Xhebrailin tek koka. U rrotullua me mundim në krevat dhe të kishte kokën vuri këmbët. Por Xhebraili i doli prapë te koka. Nelë Kazani disa herë e bëri këtë veprim, derisa Xhebraili i tha:

- Kthehu dhe rrotullou sa të duash, te koka më te.

# homazh

## Arsimtar dhe atdhetar i devotshëm


### Ndahet nga jeta veterani i arsimit Prof. Emin Pustina

Ndahet nga jeta veterani i arsimit Prof. Emin Pustina

Në moshën 78 vjeçare papritmas në Dibër të Madhe ndërroi jetë intelektual, patrioti dhe veterani i arsimit shqip Prof. Emin Pustina u lind në Dibër të Madhe në familje të shquar patriotike. Arsimin fillor e kreu në Dibër të Madhe. Liceun artistik e kreu në Tiranë. Kurset pedagogjike, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe Fakultetin për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe i kreu në Shkup.

Prof. Emin Pustina fillimisht punoi si mësues në Reçicë të Tetovës, ku me punën e tij të zellshme la kujtime të pashlyera te banorët e kësaj ane që ruhen edhe sot e kësaj dite. Ndërsa dyzet vitet e tjera të shërbimit i kaloi në Dibër të Madhe.

Në nekrologun e tij kushtuar shokut të ndjerë të gjeneratës, Prof. Dr. Mahmud Hysa, theksoi se "vdekja yte më traumatizoi emocionalisht sepse kisha planifikuar të takohemi në këto pushime dimërore për të biseduar sërish gjërë e gjatë për të kaluarën tonë, për idealet tona, për vizionet tona, për punën tonë pedagogjike, për nxënësit tanë që na e kanë zbardhur faqen, për shërbimin tonë që i kemi bërë vendlindjes. Ti ishe enciklopedik në mendime, në ide e në njohuri, ishe i mprehtë, i logjikshëm, i arsyeshëm, i matur, i sjellshëm me një rezatim mahnitës kulturor që urrente tradhtarin, poltronin dhe shpirtvoglin. Përveç tipareve burrërore, fisnike e bujare ti dalloheshe edhe për tiparet shkencore, të dashurisë ndaj gjuhës, ndaj kombit, ndaj atdheut. Dalloheshe me tiparet e mësuesit të devotshëm, edukatorit dhe pedagogut të popullit, me tiparet e veteranit të arsimit ko-



mbëtar. Plot dyzet vite i kalove me ditat në dorë si mësues i popullit, si njeriu që i armatosi nxënësit shqiptar me diturinë si armën më të fuqishme, me vetëdijen, edukatën dhe kulturën kombëtare. Një gjë të tillë mund ta bënte vetëm një personalitet siç ishte ti, që e njihje më së miri të kaluarën historike, kulturore, shkencore, artistike të popullit tonë. Shpeshherë thoshje se mësuesi i mirë është ai që nxjerr nxënësit të mirë.

Ty ke mbetur i paharruar te mijëra nxënësit të tu për sakrificën, punën dhe mundin gjatë ligjëtimeve të tua për tu dhënë sa më shumë dituri nxënësve. Mbetet fytyrë emblematike për bashkëqytetarët e tu, si model për mësuesit, se si duhet të punojnë, të angazhohen dhe të krijojnë imazhin e një mësuesi të shkëlqyer. Ti shkruajta një faqe të ndritur në historinë e qytetit tonë, të arsimit kombëtar dhe të idealeve kombëtare. Ti më shumë veprime, mendoje dhe krijoje se sa që flisje.

Indjeri Prof. Emin Pustina, u varros të dielën në Dibër të Madhe në praninë e familjarëve, farefisit dhe shokëve e miqve.

Rexhep TORTE

## Lamtumira e nënë Beres!

Krejt papritur, pas ditën e 2 janarit, në duart e mjekëve, iku nga kjo botë, nëna e mirë dhe një grua model, Bere Gjapi. Ceremonia e saj, ishte nga më të mëdhatë, jo vetëm për faktin që ajo u nda rrufeshëm, duke lënë në pikëllim familjen dhe të afërmit, por mbi të gjitha për gjurmët që la pas, në gjithë këto vite të jetës së saj.



Ajo lindi në fshatin Sohodoll, në një familje të thjeshtë, por patriotike e njohur si një nga bazat e rëndësishme të luftës Nacionalçlirimtare të asaj kohe. Në vitin 1950, ajo u martua me handar Gjapin dhe jetuan së bashku mbi 60 vjet, duke lindur 5 fëmijë, të gjithë të arsimuar me shkollat të larta e specializime, konkretisht Hamziun, Miftarin, Ilirin, Ritën dhe Rustemin. Mjaft cilësi të saj, si humaniste e grua që rrezatonte mirësi e paqe e bëjnë atë që sot, të kujtohet e vlerësohet edhe në faqet e shtypit, sepse njihet prej opinionit dibran, për vlerat që la pas dhe arkivoi në vite. Ajo ishte një nga punëtorët më të shquara të para viteve 90-të në ish ndërmarrjen bujqësore të Kastriotit, si një nga më të dalluarat në punë, korrektesë

e profesionalizëm. Pas këtyre viteve, familja e saj, si shumë të tjera, erdhin në Tiranë dhe bëri një jetë normale, duke treguar edhe këtu, modelin e një zonje që ndërtonte marrëdhënie pozitive me të gjithë ata që e rrethonin. Vendlindja ishte pika e saj më e dobët dhe shpesh udhëtimet e saj, ishin drejt Sohodollit dhe fshatrave të tjerë të Dibrës, ku kishte akoma njerëz të saj që e donin dhe e respektonin. Kudo ku të ndodhte fatkeqësia, apo sëmundja, do ta kishte Beren, sepse ishte gjithnjë e pranishme në momente të tilla. Këto cilësi, ajo kërkonte t'ua trashëgonte edhe djemve të saj, që realisht gëzojnë respekt te njerëzit. Në moshën 75-vjeçare, ajo mbylli jetën e saj, por kujtimi për të, do të jetojë në vite. Ky shkrim homazh në gazetën "Rruga e Arbërit", gazetë të cilën e lexonte rregullisht, është një vlerësim jo vetëm për vitet që ajo jetoj, por më së shumti për gjurmët e pashlyera që la pas, si një nënë dhe grua model.

Nëpërmjet këtij shkrimi ngushëlojmë familjet Gjapi e Makishti.

SHUAIP METHASANI

## EPIFORE PER DOKTOR TAFËN...

Para pak ditësh, krejt papritur u nda nga jeta Dr. Mustafa Ndreka. Një atak i rëndë kardiak, një gjëmë e papërballueshme për fizikun njerëzor, ndali së punuari zemrën e doktor Tafës, sic e njihnim ne të gjithë... Dhe ndodh që në castet, në ditët e netët pambarim të dhimbjes njerëzore, të sjellim dhe risjellim nëpër mend të gjallët e njeriut që papritur u nda nga kjo botë. Për njerës si Tafa thjeshtësia, modestia, korrektësia, dashuria njerëzore në të gjallë, kishin mbuluar madhësinë e një njeriu që për gjithë jetën që jetoj ishte në roje të jetës, mbroi dhe dhuroi jetë të tjerëve, dhuroi shpresën dhe dëshirën për të jetuar.

Mustafa Ndreka lindi në një familje të thjeshtë e me tradita në Grykë-Nokë. Familja e tij atdhetare dhe arsim dashëse, bëri cmos që djali i talentuar në mësim të vazhonte shkollimin e lartë. Dëshira dhe ëndrra e hershme e tij ishte të bëhej mjek. Dhe ëndrrat nuk mbetën ëndrra për djalosin M. Ndreka, i cili me këmbëngulje, pasion dhe punë të spikatur diplomohet në fakultetin e mjekësisë si "Mjek i Përgjithshëm" Kështu celët udha e jetës për mjekun e ri e njerin e mire Tafën, udhë e cila papritur u mbyll kobshëm, e për të na lënë pas gjurmë të pashlyera në memorien tonë, në memorien e vajzës Denisë e djalit Dar, bashkëshortes Sanie, vëllezërve, motrave, miqve dhe shokëve, që në të gjallë i deshi dhe e deshën aq shumë...

...Pasi mbarova shkollën e lartë për mësuesi, u emërova në zonën e thellë të Recit, ku kontaktet e para i pata me doktorin e zonës, njëkohësisht përgjegjës in spitalit, Mustafa Ndreka, kontakte të cilat do të ngjiznin më tej një shoqëri dhe miqësi të ngushtë. Dhe kur mësova vdekjen e tij si në ekran m'u shfaqen ato vite të vështira, por dhe të bukura e mbresëlënëse mes banorëve dhe natyrës të zonës së Recit. Ndaj dhe vdekja e tij më dukej thuajse e pabesueshme, më së shumti e pabesë dhe vrastare. Doktor Tafa, sic e thërrisnin të gjithë në Rec, më dukej se ishte nisur si ngaherë drejt një të sëmurit, ishte diku në rrugë e sipër drejt Ndërshenës apo Gjuri-Recit, Bardhaj apo Krej-Recit, i papërtuar si gjithnjë, natën apo në kohë të lig, me një cantë doktori në krah po ecte dhe në këto momente në emër të detyrës, të jetës duke terror dhimbjen tonë, të fëmijëve, familjarëve, miqve dhe shokëve që ishim mpa-kur nga gjëma.

Në ato vite disi të largëta, nuk kishte si të mos më habiste gatishmëria deri në përkryerje e tij, profesionalizmi dhe përgjegjësia e lartë për detyrën sa të vështirë dhe humane të mjekut. Me këtë, ai padyshim kishte fituar respektin e thellë të njerëzve fisnik të kësaj zone. Në shumë raste kam ecur dhe unë me doktor Tafën, sidomos kur urgjenca e të sëmurit ishte natën dhe e ndjeja vetën ngushtë nga përkudësja e tij, por dhe nga respekti deri në dhimbje që tregonte ai për të gjithë, e sidomos ndaj fëmijëve. "Nuk dinë të tregojnë për sëmundjen, unë si mjek duhet t'a zbuloj diagnozën, t'a



Dr. Mustafa Ndreka

mjekoj dhe t'a mund atë," thoshte, dhe sytë i shkëlqenin nga mirësia. Dhe në pyjet me borë ka jetë, e ngacmoja doktorin me titullin e një filmi, kur ndodhte (dhe jo rrallë) të cante trashësinë e dëborës më orë të tëra në udhën drejt të sëmurit...

Para terapisë doktor Tafa kishte fjalën e ëmbël, kurajon që i jepte të sëmurit, humorin dhe kujdesin që tregonte për cdo moshë, për fëmijët, që ishin si gjithnjë, të privilegjuarit e doktorit. Ndoshta për këtë arsye në vitin 1985 përfundon me sukses specializimin pas universitar si mjek pediatër.

Për doktor Tafën specializimi nuk ishte qëllim në vetvete, fjala vjen, për të zënë një vend në një institucion shëndetsor, apo, në Spitalin e Peshkopisë. Ai do t'a priste me kënaqësi emërimin si përgjegjës në spitalin rural Fushë -Alie. "Eshtë pjesë e vendlindjes time dhe asaj zone ju kam borxh rritjen, edukimin, shkollimin dhe më vjen mirë që më në fund do të jem i vlefshëm t'ju shërbej." Dhe doktori, për të qënë sa më afër atyre që u "kishte borxh", mori dhe familjen me vete dhe punoi me përkushtim dhe pasion për katër vite me radhë. Për katër vite ai ishte pranë bashkëfshatarëve të vet, pranë vëllezërve dhe motrave që i deshi dhe e deshën aq shumë, e gjithnjë i thjeshtë dhe i dashur, professional dhe i përkushtuar në shërbim të shëndetit të tyre, në shërbim të jetës.

Më tej, dr Tafa shërbeu në spitalin e Peshkopisë, si mjek pediatër. Pavioni ku punonte ishte shumë i "ngushtë" për të, ndaj ai, sic kishte vepruar në Rec e Fushë-Cidhën, ishte në cdo shtëpi ku e kërkonte shëndeti i nënës dhe fëmijës. Në cdo kohë, në cdo moment i palodhur, i thjeshtë, i qeshur, tolerant, bujar e profesinal! Kështu e kemi njohur mjekun Mustafa Ndreka, që tashmë mbante mbi supë një përvojë të gjatë e të vyer jo vetëm si mjek pediatër... Nuk janë të pakta rastet kur doktori "zihej ngushtë" nga falenderimet pafund e mirnjohja e thellë që tregonin bashkëqytetarët e tij për shërbimin ndaj të sëmurit, sidomos përkushtimi ndaj shëndetit të nënës dhe fëmijëve.

Nga viti 1993, ai do të drejtonte Poliklinikën Rajonale Dibër, dhe nga

Për njerës si Mustafa Ndreka, thjeshtësia, modestia, korrektësia, dashuria njerëzore në të gjallë, kishin mbuluar madhësinë e një njeriu që për gjithë jetën që jetoj ishte në roje të jetës, mbroi dhe dhuroi jetë të tjerëve, dhuroi shpresën dhe dëshirën për të jetuar.


viti 1998 deri në vitin 2005 do të ishte drejtor i DSHP në prefekturën e Dibrës. Dhe në këto vite të burokracisë zyrtare, ai kurrë nuk u shkëput nga pacientët e tij të vegjël, duke mos e lënë për asnjë cast stetoskopin në sytar dhe kualifikimin bashkëkohor menjëanë...

Në një CV që kam përpara janë të shumta kualifikimet e mjekut pasionant të organizuara nga Ministria e Shëndetsisë apo nga UNICEF etj., kurse të cilat e rritën më tepër kualitetin profesional të dr. Tafës, por dhe aftësitë menaxhuese e drejtuese. Për rrjedhojë ai jo vetëm u bë një lektor i kërkuar në shkollat e kurset për mami dhe infermier, por dhe drejtor drejtues e menaxhues i kurseve të organizuar nga UNICEF në disa rrethe të vendit. Kontributi i tij në këtë drejtim ka qënë dukshëm i spikatur.

Ai ishte gjithnjë në kërkim të së resë, gjithnjë në lëvizje, armiq të përherëshëm për të ishin plogështia dhe rehatia... Në një moshë jo shumë të re ai u tregua i gatshëm thirrjes për të punuar në spitalin e Bajram Currit si pediatër, sepse një mjek i tillë atje mungonte... E kush do t'a mbushte këtë mungesë më mirë dhe më profesionalisht se dr Tafa? Dhe kur të fliste për punën dhe njerëzit e Malësisë së Tropojës s'kishte se si të mos vije re në sytë e tij dashurinë njerëzore që rridhte pa pre si ujrart e Valbonës... Jam më se i sigurt se atje ka lënë gjurmë të pashlyeshme të një pune pasionante e të njeriut fisnik.

E tashmë kur mjeku dhe njeriu i mirë Mustafa Ndreka nuk është midis nesh, silueta e tij shfaqet dukshëm në ambientet ku ai punoi për më shumë se 30 vjet, shfaqet në rrepirat dhe shpatet e maleve të Grykë-Nokës ku lindi dhe u rrit, në udhë e shtigjet ku eci, në shtëpitë dhe vendet ku ai jetoj, në qënien dhe fizionominë e fëmijëve që rriti dhe edukoi, në jetët që shëroi dhe dhuroi. Eshtë një silueta që me shumë gjasa vetëm kthjellohet. Dhe për të, gjithsesi dhe për të mbushur boshllëkun e lënë pas, përshpirtim mallshëm, Zoti e bekoftë doktor Tafën! Dhe u nda nga kjo jetë vetëm pesëdhjetëtetë vjeç...

Islam Çenga



## Një enciklopedi për Lukanin

Vetëm pak dit para vitit të ri e pamë Faik Bruçin në një profil krejt tjetër. Na ra në duar një libër disi ndryshe nga ato që kishim lexuar më parë, një enciklopedi fisi me plot të drejtë mund ta quajmë librin "Fisi Bruçi" me autor Faik Bruçin. Libri jo vetëm nga cilësia e botimit por dhe nga përmbajtja na befason, na befasoni më shumë autori i këtij libri. E kishim njohur Faikun si një biznesmen të sukseshëm në fushën e ndërtimit, si një intelektual të kompletuar por ardhja e tij krejt pa pritur në fushën e letrave, në një fushë të panjohur për të, ishte vërtet një befasi për lexuesit. Siç duket Faiku ka punuar gjatë me këtë libër, ka mbledhur kujtime nga të moshuarit por dhe ka shfletuar dokumenta të kohës, ka bërë fotografi të ndryshme që nga Qafë-Murra e deri në Lukan, Kacni e Selishtë. Nuk ka lënë majë malesh pa shkelur e fotografuar që lidhen me Katër Grykët. Kur i shikon sot këto foto, ndoshta të bëra herët thua se kemi të bëjmë me një fotograf profesionist por në fakt është vetë aparati i Faikut që na sjell këto shkrepte profesionale në libër. Faiku nuk ka shkruar në fakt vetëm për fisin Bruçi ashtu si na thotë në kopertinë, nuk ka shkruar vetëm për Lukanin e tij të shtrenjtë. Jo në libër janë të gjithë, janë Katër Grykët e pse jo dhe më shumë, më shumë se këtë trevë e lidhin miqësitë që ka bërë me treva të tjera të Dibrës, Lurës e Matit. Në librin "Fisi Bruçi" ka shumë personazhe, të njohur e panjohur për lexuesin por që të gjithë kanë vlerat e tyre padyshim në çështjen kombëtare. E autori nuk ka lënë gjë mangët në këtë libër edhe pse mundohet më shumë të shkruaj për fisin e tij, për të parët fisit. Fundja vetë historia nga fisi nis. Autori e kalon me studime fisin Bruçi, ai shkruan dhe për fiset e tjerë që kanë jetuar e jetojnë në Lukanin e bukur. Autori i këtij libri merret gjatë me pozitën gjeografike të Katër Grykëve, me resurset e bukuritë e rralla që u ka falur natyra, me doke e zakonet e zonës, me arsimin e kulturën, me vlerat dhe kontributet e secilit që kanë dhënë në çështjen kombëtare. Shkruan bukur e me një stil tepër të thjeshtë për njerëzit e thjeshtë të cilët u lindën e u rritën këtyre anëve, ku natyra vetëm këtu ka bërë mrekulli. Faqe të tëra në libër i kushtohet Hoxhë Bucit, aktivitetit të tij sa fetar e aq edhe patriotik e kombëtar i cili në Lidhjen e Prizrenit në fakt nuk përfaqësonte vetëm Lukanin por të gjithë krahinën e Katër Grykëve, të gjithë Dibrën. E si thotë dhe vetë autori "Hoxhë Bucit është një figurë e madhe historike jo vetëm për Lukanin dhe Dibrën, por edhe për mbarë shqiptarët..." Në libër janë të gjithë bashkë, bashkë ashtu si kanë jetuar në vite, nuk është marrë autori siç mundohen sot disa të tjerë të gërmojnë në plagë të sapo mbyllura por kur i ngacmon ende kullojnë gjak. Jo, jo Faiku është larguar nga këto metoda arkaike. Ndaj themi me bindje se libri "Fisi Bruçi" fare mirë mund të quhet një enciklopedi, një enciklopedi fisi.

# Shpirti ynë liridashës

Rutina e punëve të ditës, familja, fëmijët me kërkesat e tyre, shoqëria, të afërmit, angazhimet publike të rëmbejnë në ingranazhet e tyre dhe e kaluara mbetet në hije. Po prindërit tanë që kontribuan aq shumë për ne? Ata na rritën, na arsimuan, na nxorën në jetë, na bënë të pavarur të ecim në rrjedhat e kohës. Ata bënë aq sa mundën. Kështu po bëjmë edhe ne për fëmijët tanë. Ndërkohë përgjegjësia është e dyfishtë. Babai na tregonte shpesh një histori. "Kur e pyeste babai djalin se: Sa e donte ai? Djali i përgjigjej: "Edhe unë do t'i dua fëmijët e mi, aq sa ti më do mua."


Trashëgimi i dashurisë në breza është një virtyt. E mira është të shikojmë para, por kur enciklopedia zyrtare apo jo zyrtare ta errësojnë apo e mohojnë të kaluarën, detyrohesh ta risjellësh në vëmendje të publikut historinë. Koha po provon se kush mohon historinë, është i dështuar edhe në politikë. Historia të edukon, nuk të lejon të përsërisësh gabimet. Thonë se në politikë nuk mund të gabosh shumë herë. Ndaj amerikanët i kufizojnë mandatet politike. E mbrojnë njeriun. E njohin mirë qenien njerëzore. Ndaj atje janë universitetet më të mira të botës.

Kur punoja në Laç dhe po i tregoja një miku historinë e familjes dhe të fisit tim, ai më bëri një pyetje: "Si ka mundësi që brez pas brezi është derdhur kaq gjak nga fisi juaj?" Nuk u ndjeva mirë nga pyetja. Prita mirënjohje. Historia e fisit tonë vazhdoi e dhimbshme edhe pas Çlirimit. Por ngushëllohesh kur mëson historinë e figurave tona kombëtare. Të gjithë të zhdukur fizikisht dhe shpesh edhe si histori. Tek ne një brez është ngritur duke mohuar totalisht brezin paraardhës. A ndodh kjo në Angli, SHBA apo dhe në vende të tjera të zhvilluara? A e keni dëgjuar ndonjëherë presidentin e SHBA, Obamën, të përbaltë Bushin? Ja përse ne ecim kaq ngadalë në rrjedhat e demokracisë. Ja përse ne shpesh biem nën diktaturë apo demodiktaturë. Ne kemi pak muze. Sa të tillë kemi ndërtuar në këto 18 vjet? Ne e shkruajmë historinë dukë u lëpirë pas liderit. Ne fshijmë nga faqja e historisë cilindo që guxon të shprehet kundër liderit. Në verbëri ne mbrojmë me vetëmohim edhe atë për të cilën nuk jemi të bindur, por që kemi një interes çasti.

Sidoqoftë, unë besoj se Shqipëria ka hyrë në një EPOKË TË RE. Zhvillimi i arsimit të lartë privat, hapja në mënyrë masive e degëve të shkencave politike do të prodhojë politikanë dhe politikë bashkëkohore, historianë dhe histori të qëndrueshme që t'i rezistojë kohës. Ne nuk kemi çfarë dhe pse të fshehim.

Ky libër që botohet me rastin e 89 vjetorit të lindjes së babait tonë të dashur, vetëm rreth katër vjet pas ndarjes nga kjo botë, është një kontribut në kontekstin e mësipërm, por dhe plotësim i një dëshirë të tij. Në librin "Në emër të jetës", një monografi kushtuar babait, kam bërë publik faktin që ai shkruante vazhdimisht dhe jepte opinionet e tij për çdo gjë që mendonte. Për historinë e fisit tonë shpesh është keqtrajtuar nga ata që ishin të interesuar ta mohanin atë. Ky arkiv përbën një pasuri të madhe për ne dhe ai kishte dëshirë që t'i botonte. Kuptohet, përgjendhja dhe redaktimi i tyre kërkon një punë të madhe, për shkak se ato janë në dorëshkrim. Vëllai im, Sakipi, ka bërë një punë të konsiderueshme për përgjendhjen e tyre. Në këtë botim kemi paraqitur një pjesë të kujtimeve të babait për kontributin e fisit Cami në një periudhë 100 vjeçare (1844-1944) për liri dhe pavarësi kombëtare, si dhe për arsimin në gjuhën shqipe. Edhe pas 1944 historia jonë është e tillë. Shumë e larmishme dhe trazuar. Me ministria dhe të burgosur politikë. Kjo histori le të shërbejë për të reflektuar, për të nxjerrë mësim.

Sot në Botën Globale, të shkruash për një fis, për një familje, të harxhosh energji në këtë drejtim tingëllon pak jashtë kohe për ata që nuk i njohin vlerat e trashëgimisë dhe rreziqet asimiluese të Globalizimit. Por kush është mbështetur tek Frojdi, nuk ka gabuar. Po, duhet një sjellje e re në kohë të reja. Por pyetja që më mundosh shpesh është: Pse më ndizet gjaku sa herë vihem në provë për të bërë një padrejtësi, të paktën kur unë e konceptoj si të tillë? Pse më ndizet gjaku kur vihem përballë një mohuesi të historisë së kombit tim? Pse refuzoj të kryej një veprim kur ai është jashtë bindjeve të mia? Kjo, mesa duket, është gjenetike! Ndaj Demokracia është një pasuri e madhe për ne. Në këto 18 vjet secili ka gjetur veten. Secili e ka ndërtuar jetën e tij ashtu si e ka menduar dhe kjo zgjedhje është e tij. Secili ka ecur mbi bazën e marrëdhënieve dhe të rrethave që i janë krijuar ose që ka krijuar. Kështu është



*"Camet kanë luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve të huaj, për çlirimin e atdheut tonë, janë dalluar për virtytë të larta etiko-morale, për respektin e besës së dhënë, për motive atdhetare, për çiltërsinë për nderimin e shokut e të mikut, virtytë këto të njohura të fshatit të brezave dhe kohëve të ndryshme, mandej kanë bërë fli edhe jetën për kauzën e çlirimit të atdheut tonë."*  
Prof. Dr. Xhemil Frashëri, Historian

*Nga fundi i dhjetorit të vitit 1908 u formua në Dibër të Madhe klubi atdhetar "Bashkimi" që kryesohej nga Hafis Sherif Langu dhe me anëtar të këshillit administrativ Kadri Fishtin, Riza Rusin, Ibrahim Xhindin, Eqerem Camin, Abdurrahim Tërshanën dhe Ibrahim Jegenin.*

Prof. As. Dr. Arian Kadiu  
Monografia "Dibra e Madhe" faqe 188

*Shumë prej tyre u ekzekutuan ose vdiqën në tortura, por nuk u dhanë armiqve atë që kërkojshin. Theksohet trimnia e pashoqe e gjithë partizanve... por mbi të gjitha vihet në dukje heroizmi i Ahmet Camit, i cili i paska sulumue tradhëtarët dhe genka kacafytë me tërbim e urrejtje.*  
Haki Stërmilli, Ditari partizan, Shkrimtar

*"Shtëpitë e fisit Cami u bënë preja e parë e armikut duke u djegur tërësisht. (Kryengritja fshatare e Shqipërisë së mesme 1914-1915) faqe 292"*  
Prof. Dr. Gazmend Shpuza, Historian

*"Camet janë një fis, (familje) e madhe, pari e Dibrës që shtrihet në fshatrat e Gjoricës, Viçishtit, Golevishtit, Sepetovë dhe në Dibër të Madhe." Që në vitet 1920-1930 ky fis përbëhej nga 60-70 shtëpi.*  
Dr. Milenko Filipoviç, Libri "Golloborda"

më mirë. Babai na e ka ushqyer dhe edukuar këtë mënyrë jetese dhe këtë mënyrë të menduarit. Secili ta ndërtojë jetën e tij në mënyrë të pavarur. "Ndërtoni familjet tuaja - na thoshte shpesh - dhe unë nuk ju kërkoj asgjë, vetëm mirënjohje." Sa bashkëkohore tingëllojnë sot këto këshilla.

Mirënjohje baba, për kontributin tënd të shumëfish-të! Mirënjohje nënë, për dashurinë e pafund që na fale!  
Shpëtim Cami